BKSH

BKSH

BKSH

BABA-TOMORRI

Vjersha

proj

A. Z. ÇAJUP

Shqipja gysh u është dukur?
Sa e ëmbël, sa e bukur?

BOTIM I DYTË
(proj trashëgimtarve)

TIRANË
Shtypshkronja „Gutenberg" — 1935

BKSH

Dy fjalë

Këto vjersha që dalin sot në dritë janë shkruar për të rrëfyer që Shqipja ësht gjuhë si edhe të tjerat, në mos më mirë. Në mos dimë t' a kuvëndojmë a t' a shkruajmë si duhet, ësht se s' duam t' a mësojmë; dhe fajn e kanë: priftët e hoxhët, Kisha dhe Xhamia, Qeverri' e Turqisë. Po fajn më të math e kanë ata Shqipëtarë që besojnë të huajt, dhe shiten, e kërkojnë të shesin dhe Shqipërinë!

„Ç' është gjuha Shqip?", thonë ca kokëprishur. - „Gjuha Shqip", o vëllezër Shqipëtarë, ësht gjuha e Shqipërisë; ajo, që na flet mëna në djep; ajo e Skenderbeut dhe

e stërgjyshëvet t' anë, që kanë nderuar Atdhenë; ajo e vjerahëtorit të madh „Naim-Beut", që rrjedh si mjaltë; ajo e gazetavet të bukura që dalin në Bruksel e në Sofje e në Bukëresht; ajo e shoqërisë „Përlindja dhe Dituria"; dhe ajo e shoqërivet të Italisë e të tjera e të tjera... S' ësht mjaft për të bindur që kemi gjuhë të bukur?

Po, kush shitet me ergjënd
nukë bindetë me mënd...

Këto vjersha ndahen në tri pjesë, pas qëllimit që kanë:

1. Atdheu
2. Dashuria
3. Përralla të rreme e të vërteta.

Në mos janë shkruar mir' e bukur, janë prej zëmre Shqipëtari, pa ndonjë qëllim tjetër, përveç dëshirës së mëmëdheut e për Shqipen, për të cilat cilido mëmëdhetar

duhet të punojë sa t'i epet, pas fuqisë që i ka dhënë Zoti. Kush pak, kush shumë, po ësht nevojë të punojmë të gjithë për Shqipërinë.

U lutem mëmëdhetarvet të më ndjejnë për fjalët e huaja që do të gjejmë. Po, i mjeri!... Kam vjet shumë që jam larguar nga Shqipëria, dhe s'mund të them se Shqipen e di mirë. Pastaj më duket se nuk duhet të qërojmë Shqipen nga gjithë fjalët e hueja, se gjithë gjuhët janë lidhur me njerajetrën, dhe janë huarë. Ç'i mbetet gjuhës Franceze po të mos ketë fjalët Latinçe dhe Elinishte? Ç'i mbetet gjuhës së Grekut, po të qërohet nga rrënjët e Shqipes?

Nuk ësht pra turp të shqipërojmë fjalë të huaja kur ësht nevojë, ashtu si kanë bërë gjithë kombet e qytetëruarë. Një gjë duhet të kërkojmë, e t'a harrijmë: **të shkruajmë të gjithë me një Allfabet.**

Ndaj, Shqipëtarët që shkruajnë libra e Gazeta, duhet të mblidhen e të mendonen mirë për të përdorur gjithë një sua shkronjë, për përparimin e gjuhës s'anë, e cila do të sjellë mbrodhësinë e bashkimin e Shqipëtarëve dhe lirin e Shqipërisë...

Ndë Kairo, 1902.

BKSH

Pjes' e Parë

ATDHEU

BKSH

BKSH

Baba-Tomorri

Baba-Tomorr, Kish'e Shqipërisë
mal i lartë, fron'i Perëndisë!
Tek Ti vinin njerëzit qëmoti
për të msuar se ç'urdhëron Zoti.
Tek të lutem dhe u' duke qarë
të msoj ç'thotë dhe për Shqipëtarë.
Kanë qënë trima të lëvduar
dhe në luftë s'janë turpëruar.
Qenë trima dhe mëmëdhetarë,
besa, fea s'i kishte dhe ndarë...
Shkonin jetën me pushkë në dorë
e donin Shqipen; s'qenë tradhëtorë!
Lulëzonte gjithë Shqipëria,
s'e kish shkelur, si sot, robëria,

Grä e burra donin Shqipërinë
djem e çupa këndonin lirinë.
Sot qysh gjëndet komb'i Shqipërisë?
I përmbysur nga xgjedh' e Turqisë!...
Shqipëtarët si dhe bakëtja
xbathur, xveshur, vdesin nga uria!...
... Shqipëtarët?... Sot s'ka Shqipëtarë.
Turku, Greku na kanë përndarë!
Prifti, hoxha, kisha dhe xhamia
na gënjejnë... U-prish Shqipëria...

Mal i lartë, me krye në djell!
Fron'i Zotit q'është Mbret në qiell!
Baba-Tomor! O mal i uruar;
Ç'kanë gjarë, gjithë ç'kanë shkuar,
i di vetë; s'duhet të t'i themi;
Ç'do të gjajnë, të lutem, rrëfemi.
Sot e tutje, ç'thotë Perëndia?
Do të hoqë shumë Shqipëria?
Ç'faj ka bërë? Ç'gjynae paguan?

Nga Turqia të tërë shpëtuan.
Greku, Serbi, Vllahu, Bullgari
Nënë zgjedhë mbeti Shqipëtari!
Ç'thotë Zoti për kombinë t'ënë?
Do t'a lërë nënë Sulltan-qënë?
Na shkretoi, na preu, na griu
na çnderoi dhe gjaknë na piu!
Na mundoi, shpyrtin na nxori!!!

I'shiu lottë dhe më tha Tomorri:

„O Shqipëtarët e gjorë!
Ndëgjoni Baba-Tomorrë:
Komb'i juaj s' vete mbarë
se besët u-kanë ndarë.
Besa e bashkon njerinë;
ju pse ndani Perëndinë?
Si Ungjilli dhe Kurani;
Nukë na dietë fundi.
Me qiejtë mos u-mbani
se nukë mbaen gjikundi

Të Krishter' e Myslimanë
gjithë një Perëndi kanë;
Jini një gjak mor të mjerë,
dhe në një vënd kini lerë.
Jini gjithë Shqipëtarë
s' jini grekër a Tartarë.
Hiqni dorë nga rreziku
Shihni se ç' punon armiku
i pabesi dhe i ligu.
Mblidhuni të bëni benë,
të kujtoni Skender-benë,
të duani Mëmëdhenë.
Të mos e lini të shkretë.
Ngrihi t' a shpëtoni vetë,
se u ndin Zot' i vërtetë.
Mos e peshoni Turqinë
Mos e besoni Morenë,
Në duani Perëndinë
të duani Mëmëdhenë.

Erdhi dita të leftojmë
për lirin e Shqipërisë,
ja të vdesim ja të rrojmë
si burrat e trimëris."

BKSH

Mëmëdheu

„Mëmëdhé" quhetë toka
ku më ka rënurë koka.
Ku kam dashur mëm' e atë,
Ku më njeh dhe gur' i thatë.
Ku kam pasurë shtëpinë
Ku kam njojtur Perëndinë
Stërgjyshët ku kanë qënë
dhe varret q' i kanë vënë.
Ku jam rritur me thërrime
Ku kam folur gjunë t' ime
Ku kam fis e ku kam farë
Ku kam qeshur ku kam qarë
Ku rroj me gaz e me shpresë
Ku kam dëshirë të vdes.

Shqipëtar !

Shqipërin' e mori Turku
i-vu zjarr!
Shqipëtar mos rri po duku
Shqipëtar!

Mjaft punove për të tjerë
o fat-keq!
Kujto vende tek ke lerë
dhe tek heq.

BKSH

Të ka bërë Perëndia
luftëtar,
Si s' të lodhi Robëria
Shqipëtar!

Erdhi dita të ngresh kokë,
të kërkosh
Lirinë; bashkë me shokë
të lëftosh!

Mos bëni si kini bërë
gjer më dje.
Po të lëftoni të tërë
për Atdhe:

Pesë qint vjet kemi rruar
me pahir
Lidhurë nga këmb' e duar
me zinxhir!...

BLSH

Musylman' e të Krishterë
jemi keq!
Të ngriemi që të tërë,
djem e pleq!

Të ngriemi të dëftojmë
trimëri,
Ja të vdesim ja të rrojmë
për liri!

O moj Shqipëriz' e-dashur
mëmëdhe,
Të sho me buzë të plasur...
si më she.

U-shkretove anë mb' anë
Shqipëri,
Se Shqipëtarëtë s' kanë
dashuri.

BLSH

Gjithë djemtë që ke qarë
dhe mban zi,
Për Morenë janë vrarë,
për Turqi!

Ç' vish robat' e Robërisë
mëmëdhe.
Vish armët' e Trimërisë
se ke ne!.

BKSH

Ku kemi lerë?

Në ç' vënd kemi lerë?
Ku na bëjnë nderë?
—Në Shqipëri.

Po njeriu vetë
Cinë do në jetë?
—Do vënd' e-ti.

Ku i-duket balta
Me ëmël se mjalta?
—Në Shqipëri.

Ku rron me një shpresë?
Ku kërkon të vdesë?
—Në vënd të ti.

Ku munt të gëzojë
Dhe me nder të rrojë?
—Në Shqipëri.

Për se të punojë
Dhe të lakëmojë?
—Për vënd' e-ti.

Trim' i Shqipërisë

Kush ka qënë trim një herë?
Alexandr' i-Math i-vjerë,
Pirua me shokë të tjerë,
Në Shqipëri kanë lerë.
Po nga të gjithë m' i-zoti,
Skënder-beu Kastrioti.
O mbret i-dashur ku je?
Ku je more Skënder-be?
Si duron ti nënë dhe?
Nukë të vjen keq për ne?
Që ditënë që na le,
Vëndi yn u-bë **raje**!...
Të lutemi dit' e natë,
N' atë jetë ku ke vatë,
Dërgona shpres' e uratë,
Të mos rrojëmë si gratë...
Të ngriemi të lëftojmë,
Turqit këtejë ti dbojmë,
Shqipërinë ta shpëtojmë
Dhe lir e me nder të rrojmë.

Dëshir' e Skënder-beut ditën që vdiq

Sa rrojta s' u turpëruam;
Të gjithë bashkë lëftuam,
Vëndinë tën' e-nderuam
Se nga Turqit e-shpëtuam.
Po tani u afërua
Dit' e fundit dhe për mua
Gjithë këtë ditë presëm
Komi ler' e dotë vdesëm,
Njeri për jetë s' ka mbetur,
Dheu të gjith' i-ka tretur;
Po lum kush është përpjekur
Dhe për Atdhenë ka vdekur,
Ndaj desha, sa jam i-gjallë,
Tu mbleth t' u them këto fjalë:

O vëllezër Shqipëtarë
U lutem të bëni mbarë
Gjithë bashk' e të pa ndarë.
Mysliman' e të Krishterë
Perëndia na ka bërë,
Jemi vëllezër të tërë.

Zoti kur bëri insanë
Me një fytyrë të naltë,
Të Krishter' e Myslimanë
I gatoi nga një baltë.
Zoti me të math të-Vetë
Është një dhe j-vërtetë
Si këtu dhe n' atë jetë.

Si Ungjilli dhe Kurani;
Mos e ndajni Perëndinë,
Shoku shoknë mos e hani,
Si punoju' ata që s' dinë.

Besa ësht e Gjithësisë;
Ne jemi të Shqipërisë
Se kemi pirë një sisë.

Për Perëndi që besoni,
Shqipërinë mos harroni
Pra faluni si të doni...
Faluni te Perëndia
Të shpejtojë Shqipëria
Nga e-ndyra Robëria.
Tani ta shpëtoni vetë,
Se unë nukë kam jetë,
Vete to Zot' i-Vërtetë.
Doti lutem duk' e qarë
Të jetë me Shqipëtarë
Dhe t'u apë dashurinë
Të nderojnë Shqipërinë.

BIBLIOTEKA

SULLTANI

Jam Sulltan, mbret i-vërtetë,
Shoq të tjerë s' kam në jetë;
Gjakëtor e zemër-derr,
Nga frika më bëjnë nder!..
Dolla nga fund' i Asisë
Si rrebesh' i Perëndisë:
Vrava, preva e shkretova!
Botën me gjak e-mbulova!
Kur zotova Anadollë
Erdha mora dhe Stambollë,
Njerzit i shkova në thikë!
Dhe kush mbeti rron me frikë!..
Jam i-keq si egërsirë!
Të urtët janë të mirë,
Dua të quem i-marrë,

Po puna të vejë mbarë.
Thera Grekër e Bullgarë,
Thera Ermenët e-mjerë.
Thera sa munda të tjerë!
Egërsirë si ariu,
Me fytyrë si njeriu
Më dërgoi Perëndia
Që të vuaj njerëzia!
Evropa qo më shukon,
Të më bëjë gjë s' guxon
Se ka mejtime të tjera...
Prisha, vrava, preva, thera!
Bëra... po ç' nukë kam bërë?
Prisha botënë të tërë!
Mysliman e të krishterë
Kam dërguar n' atë jetë
Më tepër se ç' vdiqnë vetë!
Jam i-zoti, rroj me pallë,
S' dua të sho njers të gjallë!
Nat e ditë gjak kërkoj,

Pa pirë gjak s' munt të rroj!
Dhe tani q' u bëshë plak
Nukë munt të fryem gjak!
Ata që kam nënë zgjedhë
Të mundijë tok t'-imbledhë,
Me dorë time t' i-vrasë,
Të pijë gjakn' e rajasë!
Pse s' u-bë, nga Perëndia,
Me një kokë njerëzia,
Që ta presë me një herë!
Të mos mbeteshin të tjerë!
Të mbetej dheu i-shkretë,
Se dojë të rrojë vetë;
Me egërsira të rrojë,
Pa frikë të mbretërojë,
Se më duan e i-dua,
Jemi një gjak e një sua!
S' lashë njeri pa të keq!
Gra e burra, djem e pleq
Dridhanë kur më kujtojnë.

Zun' e më punojnë varrë!
Humba Moren' e Vlahinë,
Bullgarinë me Sërbinë,
Bosnjënë me Mal-e-zi,
Gjiritnë me Thesali;
Keshë kompn' e Shqipërisë
Direk i-gjithë Turqisë;
Pse s' më priti sa të vdesë
Pa të më dil i-pa-besë
Me Shqipëri të lëftonem
Kam frikë mos turpëronem,
Kam frikë nga Skenderbeu
Mos dalë prapë nga dheu!..
Se ç' mentoj a ç' jam i-marri
S' më bën dot gjë Shqipëtari,
Dhe sa të jem vet i-gjallë
Nga' zgjedha s' ka për të dalë.
Pas meje, në këtë jetë
Guri mi gurë mos mbetë!...

Prishj' e Lëkursit nga Greku

Në Sarandë dolli Greku,
Në Lekurs' u-zu dyfeku.
O burra! o Shqipëtarë!
Greku kërkon të na marrë!
O burra! tu hidhemi!
Mos trembi se s' vritemi
Me dyfek s' goditemi!
Me këtë zë nga vërria,
U derdhë çobanëria,
Muarrë përpjetë malë,
Dhe zunë Grekët të gjallë,
Ca i-vran' e ca i grinë?
Ca i-shpunë në Janinë!
Në det ranë ca të tjerë!
Po u-prish Lekurs' i-mjerë!
O Grekër o kokë thatë,
Nukë mirret Shqipëria.
Erthi' e u-zutë si gratë!
U-turpëroj Perëndia!...

Mëmatë më mallkojnë,
Më mallkojnë të vatë
Edhe qajnë dit e natë!
Qajnë! po kush nukë qa?
Qajnë burra, qajnë gra,
Qajnë maletë për pylle,
Qajnë fushatë për lule!...
Kudo shkela u-tha bari!
Ç' la puçka e dogji zjarri!..
Egërsirë si ariu
Hëngra dhe u mish njeriu!
Si kam dashur kam punuar,
Pse nukë jam i-gëzuar?
I-lik jam, të liga dua,
Nga kush më vjen frikë mua?
Nukë di se ç' kam i-ziu,
Nga frika gjaku me ngriu...
Me punëra që kam bërë,
Më duken armiq të tërë,
Mysliman e të Krishterë;
Sa dhe trimat Shqipëtarë

LUFT' E VITIT 1896

Viti nëndëdhjet'e gjashtë
Dolli dhe Morea jashtë!
Dolli Greku, të lëftojë!
Kur t' i-vemi dot na shojë!..
O Gjirit a paç belanë
Që zemërove Sulltanë
Dhe thirri Edem Pashanë
Edem pashë kordhëtarë
Me pak trima Shqipëtarë.
Kur rynë në Thesali
Anë urban' e-bënë hi,
Se kur do q' u-zu dyfeku
Po si dhia iku Greku!..
O Malet' e Dymeqësë
Edhe të Thermopilesë,
Falni me Shëndet Moresë
Të nisët e të na presë
Të gëzojmë këtë Pashkë
Në Athinë gjithë bashkë!..

V A J

O Shqipëtarë të mjerë!
Ç' u ka marrë koka erë
Derdhni gjaknë për të tjerë!
Gjithë Trimat e Turqisë
Ishin djemt e Shqipërisë.
Ata që bënë Moremë
Gjithë Shqipëtarë qenë.

Luftonte Turku me Junanë,
Po Shqipëtarëtë ç' panë
Q' u-ngrenë të gjith' e vanë
Ca më nj' an' e ca më nj' anë?
Musilman' e të Krishterë
Në luftë vanë të tërë;

Lanë Memëdhenë shkretë,
Vanë të vritenë vetë!
Sos vriten për Shqipërin...
Po për Moren' e Turqinë!
Në bërrul të penxheresë
Qan Shqipëtarka pa shpresë...
Qan e të këput kaurka!
Për karshi qan edhe Turka!
Që të dya Shqipëtare
Qajn' e s' pushojënë fare;
Se djemtë në luft' u vanë;
Muslimani për Sulltanë
I krishteri për Junanë;
Me njëri-jetrin u vranë!...

Mëm' e zezë del në shkallë,
Qan e ulërin për djalë...
Si burim i venë lottë;
Djalit të vetëm i thotë:
„Bir' o bir, në luftë ç' deshe?
Pse nukë rrije tek jeshe?

Turkun e Grekun ç' i keshe?
Sos lëftonte Shqipëria
Që nxive ditët e mia?...
Vajte në luft' e më s' erdhe!...
S' t' erdhi keq për gjak që derdhe?...
Sos e derdhe për Atdhenë?
Po për Turq e për Morenë!
(Si të t' a fal marrëzinë?
Sos vdiqe për Shqipërinë?
Për një derr e për një dhelpër,
Për Sulltan' edhe për Grekër
Vajt' e humbe këtë jetë!...
Ike e më le të shkretë!...
Bir o bir!... u-mbyll shtëpia!...
U-shoft' e tërë Turqia
U-shoftë dhe Grekuria)
Mos u-gjente fis e farë!...
Gënjejnë me Shqipëtarë!...
Sa mëma që kanë qarë
Për djemtë q' u janë vrarë!...

(E zeza!... që më lâ djali!...
Bir o bir... ç'më mori malli!...)
Bir o bir!... Ç'punë punove!...
Pleqërinë m'a shkretove!...
Djalërin' e trimërinë
S'i humbe për Shqipërinë!...
Vajt' e lëftove për botë,
U-mundove dëm e kotë!...
Bir o djal' i vetëmë
Se ç'më nxive jetënë!.."

BKGT

ROBËRIA

E-dashura Mëmëdhe
Të dua dhe kshtu si je!
Po kur të të sho të-lirë
Do të të dua më mirë.

Qajni pyje, fusha, gurë,
Qajni male me tëborë!
Shqipëria mbet e-gjorë
Dhe nukë she dritë kurrë:
Një mjergul e keq' e shkretë
E-ka mbuluar për jetë!

Një gazep, një errësirë!
Vetëtit edhe gjëmon!
Rojnë me zëmër të ngrirë,
Nga frika kurkush s' gëzon!
Njerzitë kurrë s' këndojnë,
Dhe bilbilëtë vajtojnë!

Qiameti shkretëtira!..
Zogu vete zë folenë,
Njeriu le Mëmëdhenë
Se mbretëron egërsira!
Për Shqipëri dëshërojmë
Se në vënt të-huaj rojmë.

Robërinë si duron
O moj Shqipëri e-mjerë?
Shpëtove vënde të tjerë,
Vetë nënë zgjedhë rron!
Shqipëtarë bëni benë
Të lëftoni për Atdhenë.

E-dashura Mëmëdhe
Të dua dhe kshtu si je!
Po kur të të sho të-lirë
Dotë të dua më mirë.

Besa - besë

Gjithë vëndetë gëzojnë
Ti Shqipëri pse pushon!
Gjithë njerzitë këndojnë
Ti Shqipëtar pse rënkon?

Gjithë duanë lirinë
Dhe pa të njerin s' rron,
Ti Shqipëtar, Shqipërinë
Në zgjedhë si e-duron?

Zgjohuni o Shqipëtarë,
Erdhi dita për Liri:
Zini luftë me Barbarë,
Përpiqi për Shqipëri.

Të Krishter' e Myslimanë,
Të tërë një sua kemi:
Gegë, Toskë, Dibrianë,
Gjithë Shqipëtarë jemi.

Mblidhuni të bëjmë benë
Të gjithë dorë për dorë:
Të duamë Mëmëdhenë
Edhe malet me tëborë.

O malet e Shqipërisë
Që në Prevez e në Kroje,
Egërsira e Asisë
Ngjerë-kur doi' u-zotojë?

Që ditënë që u-shkeli
Robëria, dhe ngjer sot
Nukë bën me bar Dhembeli
Dhe Tomorri qan me lot!...

Male, me krye në Qiell,
Si duroni Robërinë?
Ju që shini drit' e diell
Pse s' ndrini dhe Shqipërinë?

Ku janë vaftet e-parë
Që kini dhënë yrnek!
Ku ini o Shqipëtarë,
Pse s' ndëgjonet një dyfek?

Apo humbi trimëria!
Apo s' doni Mëmëdhenë!
A u-shua Shqipëria
Që ka pjellë Skender-benë?

Pse rrini lidhur me lak?
Pse s' shpëtoni vëndë tuaj?
Apo s' u-mbeti më gjak
Se e-derthtë për të-huaj!

Mirri pushkatë në duar
Edhe bëni **besa-besë**:
Shqipëria do shpëtuar,
Kokë Turku të mos mbesë!..

BIBLIOTEKA

Ç' jemi!...

Greku dhe Bulgari,
Dhe Turku Barbari
Nukë dinë ç' janë..
Dhe turp nukë kanë!

Nevë, Shqipëtarë,
Jemi komb' i-parë,
Po për turp e-kemi
Të themi se ç' jemi

Njeri, do Greqinë,
Tjetri, do Turqinë,
Edhe Shqipërinë
S' duanë t' a-dinë!

Ç' jemi? o të mjerë
Jemi Shqipëtarë,
Si ne s' ka të tjerë,
Po punoni mbarë...

Në kini, o shokë,
Mëndjenë në kokë,
Harroni Morenë,
Dojni Mëmëdhenë.

Nga Turqit largoni,
Dhe më mos i-doni,
Se armiq na kanë
Duan të na-hanë!

BUSH

Lini djallëzitë,
Lini prapësitë...
Po si Perëndinë
Dojni Shqipërinë.

Vënd' i Skender-beut,
M' i-bukur i dheut,
Kur dotë gëzojë
Dhe të lulëzojë?

Balt' e Shqipërisë,
Djep' i Trimërisë,
I-ëmbël si mjaltë...
Zoti na e faltë!

BUSH

Punërat' e Perëndisë

Zot' i-Math e i-Vërtetë
Ç' do pun' e-ke bërë vetë:
Bëre qiejtë dhe denë,
Bëre yjëtë dhe dhenë,
Bëre diellin me dritë,
Bëre nat' e bëre ditë,
Bëre erënë dhe retë,
Bëre pemëtë me fletë,
Bëre hënëzën me yje,
Bëre fusha, male, pyje,
Bëre zogtë që këndojnë,
Dhe lulet që lulëzojnë,
Bëre dimër' e beharë,
Bëre kuaj dhe gomarë,
Bëre misër edhe grurë,

PROT

Po më shumë bëre gurë,
Si bëre kaqë të mira
Bëre dhe shum' egërsira:
Bëre arinë dhe derrë,
Bëre uqër e të tjerë,
Bëre... Po ç' nukë ke bërë?
Bëre botënë të tërë;
Bëre dhe Djallë më brirë!
Ç' do pun' o-ke bërë mirë
Po një gjë bëre pa mënde
Dhe prishe punënë tënde:
Kur bëre derr' e arinë
Ç' deshe që bëre Turqinë?
Se të mos qënkej kjo farë
Bota dotë vintej mbarë,
Dheu dotë lulëzonte,
Shqipëria dot' gëzonte...

Naim-be Frashëri

Vdiq Naimi! Vdiq Naimi!
Moj e-mjera Shqipëri!
Mëndje-lartë, zëmër-trimi,
Vjershëtori si ai!..

Vdiq Naimi po vajtoni
Shqipëtarka, Shqipëtarë!
Naimnë kur t'a kujtoni
Mos pushoni duk'e qarë!

Vdiq Naimi, Naim-beu!
Vate te Zoti-vërtetë:
Qysh u-nda nga Mëmëdheu
Dhe iku e-la për jetë?

BIBLIOTEKA

Vdiq Naimi! Gjithë thonë!
Qajni Turq, qajni Kaurë!
Bilbil' i gjuhesë tonë
S' dotë ndëgjonet më kurrë!

Vdiq Naimi që këndoi
Trimërinë, Skender-benë;
Vdiq Naimi që lëvdoi
Dhe nderoi Mëmëdhenë!

Vdiq Naimi! po ç'të gjeti
O moj Shqipëri e-mjerë
Vdiq Naimi! po kush mbeti?
Si Naimi s' ka të tjerë.

Vdiq Naimi! Vdekj' e-shkretë
Pse more të-tillë burrë?
I-ndritë shpyrti për jetë,
Mos i-vdektë nami kurrë!

Atdheu dhe Dashuria.

Vitua, një pun' e madhe,
E-bukurë si zorkadhe,
Nga gjithë shoqetë ç' quan
Dhe gjithë trimat e-duan:
Për të tillë bukuri
Kush nukë ka dashuri?
Një ditë që vij në krua
Duk' e ecurë mi thua,
Poqi një Turk trim të marrë,
Tjetër herë s' e-kish parë
Robatë që kish i-ndrinin,
Dhe 'armët' i-vetëtinin!
Kur shtiu syt' e e-pa
Vito të dua i-tha,
Vito, dotë të marr, grua.

Vitua u-turpërua
Po më shum' u-idhënua
Dhe ju përgjegj: — „S' je për mua
Se u një tjetërë dua,
Jemi një bes' e një sua;
Po merre fjalënë prapë
Dhe shko kötejë me vrapë!"
— Kush është më trim se mua
Që do të të marrë grua? —
— Ai që jam vluarë
Dhe për të marruarë,
Është trim sa s' gjëndetë,
I-mirë sa s' bënetë;
Ish vet' i tretë vëlla,
Kush ka qënë si ata?
Trima sa s' i-zinte plumbi!
Njëri vdiq, i-dyti humbi;
Jorgjin e-la Perëndia
Shpresë për mëmën' e-tia:
Ësht' i-vetëm e jetim

I-dashur' i shpyrtit tim
Dhe nga të tërë më trim:
Përdor pallën e anxharë,
Ësht' i-zoti të më marrë!
Ndaj të lutem mos më nga,
Të mos biesh më hata,
Se shejtani punë s' ka! —
Turku me të tilla fjalë,
Qiti të shkretënë pallë!
Nga inati u-verdhua
Dhe thirri po si dragua:
— N' është mi zoti nga unë
Le të më dalë këtunë!
Në më muntë, besa-besë!
Burri yt po le të jesë;
N' e dërgofsha n' atë jetë,
Die dotë të marr vetë! —
Vitua shum' u-frikua,
Lot' i-vininë si krua,
Dhe më shtëpi, duk' e qarë,

Rrëfeu ç' i kishte ngjarë.
Po Jorgji, kur e-ndëgjoi,
Veshi armëtë dhe shkoi,
U-ngjit malitë përpjetë
Ashtu si ngjitenë retë,
Dhe me zë të math si shkëmbi
Po thërrit sa tundej vëndi:
— Kush ësht' ai q' u-lëvdua
Që do të mundet me mua? —
Me zë të math si gjëmimi
Ju përgjegj ahere trimi:
— Unë jam ai që shtie
Dhe plumbi dëm nukë bie..
U jam ai që kam vrarë
Bejlerë dhe pashallarë,
Dhe kaurë mijë vetë
Kam dërguar n' atë jetë!
Dhe dotë trembem tani
Nga një fusharak si ti?
Tani dot' a shoç dhe vetë

Kush është trim i-vërtetë . . . —
Këto thosh Turku dhe vinte,
Po dhe Jorgjua e-printe;
Hodhi armëtë për-dhezë
Dhe zuri të sgjeshë brezë
Që kish qepur Vitua vetë,
Si fustan' e fermeletë;
Kur e-kujtoi u-shemp,
Mos pandeni se u-tremp;
Bëri kryq, e fshiu lotë,
Jam azër! hidhet e thotë,
Edhe më dorë një thikë
Ju versul Turkut pa frikë.
Trimi rrëmbeu anxharë
Dhe po hidhej si i-marrë:
Fryti era: nga rëmbimi
Lëshon flokatenë trimi:
Atje ku qe afëruar
Me gjoks hapët leshëtuar,
Ju duk, në grykë të ti,
Varturë një **hajmali.**

Jorgji kur pa hajmalinë,
Sytë përmi të i-ngrinë;
— Dale, tha, ashtu më rruash,
Pa lëftojmë kur të duash!
Po në beson Perëndinë,
Kush t' a fali hajmalinë? —
— Nënia në foshnjëri
M' a vari për mbarësi . . .
Po ç' të duetë kjo punë? —
— Një të tillë kam dhe unë!.
Shiko! mëma m' a-ka falë
Dhe mua, kur jeshë djalë! —
Të dy trimat hapnë sytë
Dhe shikonin hajmalitë
Qepur me pë të floritë;
Si njëra dhe tjetëra,
Të dya të vjetëra;
Për-mbrënda, pshellur me kartë,
Gjenë nga një kryq të artë!
Mbenë të maniturë
Dhe si të goditurë!..

Të tillë punë kur panë
U pushtuannë dhe ranë
Dhe të dy një fjalë thanë:
Të kam vëlla mor i-mjerë!
Nga një bark paskemi lerë!
Jemi një fis e një farë,
Jemi të dy Shqipëtarë,
Po besa na paska ndarë
Sa na bëri për të vrarë!
Sot që dimë vetëhenë,
Duetë të bëjmë benë
Të duarë mëmëdhenë.
Tani të marrëmë malë,
Të lëftojmë për lirinë,
Të mos kthenemi të gjallë
Pa shpëtuar Shipërinë!
Tani Viton ta harrojmë,
Me Turqinë të lëftojmë,
T' a dërgojmë nga ka ardhë,
Të shomë ditë të bardhë.

Varfëria dhe Liria.

Jam i-varfër po i-tirë,
Ndaj më pëlqen varfëria;
Kush do të rrojë më mirë
S' urdhron dot veten e-tia...
Mbreti sikur të më thotë:
„Hajde në Pallas me mua,
Të gëzosh dhe ti në botë"
Dot' i-them, zot nukë dua:
Për të ngrën' e për të pirë
Nukë munt të shesh lirinë,
I-varfën rron më mirë
S' ai që do madhërinë,
S' më duet ergjëndi mua,
Dua lirinë dhe nderë,
Dua të bëj si të dua,
Jo si të duan të tjerë.
Kush munt e bën si do vetë
Bën si thotë Perëndia;
Nukë ka në këtë jetë
Gjë m' e-vyer se liria.

Fshati-im

Maletë me gurë
Fusha me bar shumë,
Aratë me grurë,
Më tutje një lumë.

Fshati për karshi
Me Kish' e me varre,
Rotull ca shtëpi
Të vogëla fare.

Ujtë të ftotë,
Era pun' e-madhe!
Bilbili ja thotë . . .
Gratë si zorkadhe.

Burrat nënë hie
Lozën, kuvendojnë,
Pika që s' u-bie
Se nga gratë rrojnë!

Gratë venë nd' arë
Dhe në vreshta gratë,
Gruaja korr barë,
Punon dit' e natë.

Gratë në të shirë,
Në të vjela gratë,
Ikinë pa gdhirë,
Kthenenë më natë!

Gruja, për burrë,
Digjetë në diell,
Punon e s' rri kurrë
As ditën e-diel!

O moj Shqipëtarkë
Që vet' e nget qetë
Edhe drek e darkë
Kthenej e-bën vetë.

Moj e-mjera grua
Ç' e do burrë zinë
Që ftoet në krua
Dhe ti mban shtëpinë!

DHEU.

Dheu i-gjat' e i-gjerë
Na ep buk' e na ep verë
Për të ngrën' e për të pirë,
Kush di ta punojë mirë.

Si një njeri i-shtrënguar,
Dheu nukë fal gjë kurrë:
Pa munduar, pa punuar
S' na ep as misër as grurë.

Do ta punojë njeriu
Dhe ta vadijë me djersë
Që të hajë buk' i-ziu,
Nga uria të mos vdesë!

Punoni more të mjerë
Se dhe gjëri në na mbetë,
Pas neve vinë të tjerë,
Nukë sosetë kjo jetë.

Aleksandri i-Math.

Aleksandri i-Math qe burrë
Me të madhe trimëri,
Shqipëtar që s' gjëndet kurrë,
Po ç' bëri për Shqipëri?
Që foshnjë, duk' e lëftuar
Zotoi të tër' Asinë,
U-bë një mbret i-lëvduar,
Po ç' bëri për Shqipërinë?
Me punëra që punoi
Me trimëri që rrëfeu,
Që kur leu dhe sa rroi,
Ç' të mirë pa Mëmëdheu?
As një të mirë s' ka parë,

Shqipëria mbet e-mjerë...
Se trimatë Shqipëtarë
Lëftojnë për të tjerë!
Punojnë për Turqinë,
Për të ndyrënë More;
Shqipëtari, Shqipërinë,
S' e-do, bën sikur s' e-nje!
Trima, të varfër, të pasur
Shqipërin' e-kan' harruar:
Njeri nuk' i-është qasur!
Për të njeri s' ka punuar!..
Po ata vdiqnë të tërë,
Dhe Zoti le t' i-gjykojë!
Të gjëjnë si kanë bërë...
Po Shqipëria të rrojë!

PROOF

BKSH

Pjes' e Dytë

DASHURIA

BKSH

BKSH

DASHURIA.

A!

Dotë lëvdoj Dashurinë
Mbarambar me Perëndinë
Se Dashuri' e-vërtetë
Na mban të-gjallë në jetë

S' e kam parë Perëndinë,
Sho nga herë Dashurinë;
Dashuria mbretëron
Se njeriu pa të s' rron.

Cinë të besoj taninë
Perëndin' a Dashurinë?
Perëndi në këtë jetë
Eshtë Dashuria vetë.

B!

Si për burra dhe për gra
Dashuria, Djalëria,
Janë si motr' e vëlla:
S'i ndan dot as Perëndia.

I-riu me dashuri
Rron e gëzon këtë jetë,
Dhe pastaj në pleqëri
I-rëndonet jet' e-shkretë.

Djalëria qëndron pak;
Kshtu ka thënë Perëndia,
Kur bënet njëriu plak
S'i ka hie dashuria.

O ju të-ra e të-ri
Dot' u shkojë djalëria
Dhe bashkë me djalëri
Fluturon dhe dashuria.

C!

Kur jeshmë të-vegjil, si moll' e pa bërë
Putheshim nga herë ditënë të tërë;
Vij' e të kërkojë, vij' e të thërresë,
Losnim të dy bashkë, rronim me një shpresë.
Mba mënt sa të desha, mba mert sa më deshe?
Mba mënt si më thoshe e vogël kur jeshe?
Tani që jam burrë, tani q' u-madhove,
Dashurin' e parë pse vall' e harrove?
Tani q' u-poq molla e-hanë të tjerë,
Mikn' e-djalërisë s' e-qas as më derë!
Po, si dallëndyshja vete në vënt tjetër
Dhe kthenetë prapë në fole të vjetër,
Ashtu zemra jote mundet të kujtojë
Mikn' e-djalërisë dhe prapë ta dojë.

D!

Digjem, përvëlonem
Se të dua shumë.

Ditënë mentonem,
Natën rri pa gjumë.

Luletë të dinin
Mike, sa të dua,
Këtu dotë vinin
Të qajnë me mua.

Zoqtë të ndëgjonin
Dot' më rrinin pranë
Dhe dotë këndonin
Të harroj sevdanë.

As njeri në jetë
Plagën s' ma shëron
Përveç mikja vetë
Që 'vjen e-lëndon!

E!

Bukuria jote, leshërat e-tua

Po si pendë korbi, të gjata mi thua,
Ballëtë si diell, faqet si mollë,
Qafa jot' e gjatë, mesi yt i-hollë,
Sisetë si shegë, dhëmbët si thëlpënjë,
Buzët si burbuqe sytë si gështenjë,
Dora si dëborë, fjala jote mjaltë,
Kurmi yt i-derdhur, shtati yt i-naltë;
Gjithë më kënaqin, të tëra t'i dua,
Po zëmëra jote tu bë gur për mua!..

F!

E nba mënt moj Marë
Dashurin' e-parë?
Njeri nuk' e-gjegji
Se jeshmë të vegjil.

Unë pa ty s' rrojë,
Vij' e të kërkojë,
Ti pa mua s' rrojo
Vij' e më kërkoje.

Në lule me erë
Putheshim nga herë.
Dhe si burr' e grua
Losnim nënë ftua.

Një ditë, të-dyza
Losnim **Mbyla-syza:**
U fshyem pa dukur
Në ferra, në gurë.
U fshem kaqë bukur
Sa s' u gjëntm' dot kurrë...

C!

O moj lulja manushaqe
Ndëgjo dashurinë ç' thotë:
Të lozëm faqe për faqe
Të na përzienë lotë

Ma do zëmra, ma ka ënda
Të lozëm ballë për ballë,

Se zjarri që kemi brenda
Na djek sikur të mos dalë.

Të lozëm gush për gushë
Bashkë të vemi, të vimë,
Po si shtjerratë në fushë ...
Se të-ri gjithë-një s' rrimë.

H!

Kam dashurë lulet, konxhen, trandafilë,
Zogtë që këndojnë, thellëzat, bilbilë;
Tani s' më pëlqejnë, më lenë të ftotë,
Se dua një çupë si hënëz e plotë,
S' ka shoqe në botë.

Kjo është për mua lule trëndafili,
Konxhe, manushaqe, thëllëza,
Kur më shkon në rrugë, n'e lule më dorë,
Leshrat prapa krave hedhur si kurorë,
E-bardhë si borë.

Më mirrenë mëntë, nga sytë verbonem
Dhe nga dashuria digjem, përvëlonem,
Si digjen në zëmër gjithë sa e-njonë,
Maniten të tërrë trimat kur e-shonë,
Mashala ! i-thonë.

I !

Pika, pika bie shiu
Dhe dëbora flokë flokë,
Vetëtit e fryn veriu,
Breshëri kërcet mi tokë !

Le të fryjë er' e-ftotë,
S' ka ç' më bën dimëri mua :
Dashuria më mban ngrotë
Se pushtoj atë që dua.

Kur fryn era me talas,
Kur bie tëbor' e shi,
Sa fle njeriu me gas
Kur ka mikenë në gji !

VAJE

I

Që ditën që vdiqe, që kur s' të kam parë,
Lotë që kam derdhur s'më janë dhe tharë!..
Shumë vjet u bënë, sot u mbushnë dhjetë
Që kur më ke lënë dhe s' të sho ndë jetë!
Në ç' kopshë me lule ke qëndruar vallë?
S'të vjen keq për mua? s'të vjen mall për djalë?
O Engjëll i-bukur mos mëno në botë,
Ktheu të të shomë të na mbeten lotë.
S'rrojmë dot pa tynë, ti si rron pa neve?
Motëmot që rrojtim bashkë s' më-hurreve.

Atje tek rri janë qipariz' e varre...
Ktheu të të shomë, mos na le për fare!
Mos na le të gjorë, me zëmër të ngrirë;
Ktheu të gëzonesh kur të shoç të-birë:
E-ke lënë foshnjë, tani u-bë burrë:
S'harrite t'a rritje, s'të ka parë kurrë!
Për ty, shumë herë, çoç do të më thotë,
Po s'munt t'i-përgjigjem se më mbytin lotë!
Kthej kokën më nj'anë dhe vështroj përpjetë...
Dukë psherëtitur, te Zot' i-vërtetë.
O Zot i-vërtetë, s' t' erdhi keq për djalë
Kur i-more mëmën dhe më le të gjallë?
Të më keshë marrë dotë qe më mirë,
Dhe të rronte mëna të rritej të birë.
Me se rrojnë foshnjat? ç'i-rrit çilimitë?
Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitë.
O Zot, të jam falë, mos më le të-mjerë:
Dërgom' Efgjeninë t'a sho dhe një herë.
– „Pse s' kuvendon mirë, more punë-bardhë?
„Cili vdiq një herë dhe prapë ka ardhë?

„Gjith' humbasën gruan, mëmën a babanë,
„Po ata që mbeten, si ti nukë qanë:
„Të vdekurin lotë s' e-bien në jetë,
„Po lutu dhe falu të rriç djalën vetë" –

Doje drit' o Qiell, more dritën time,
Dhe më mbushe jetën plot me hidhërime!..
Tani rroj pa shpresë, ndaj s' dua të rroj,
Se dhe Perëndinë tani s' e-besoj!..

II

Ditën e vititë parë
U bë qiamet-i math,
Nga tëbora që ka rarë
Faqez e-dheut u-sbarth.
Cingerrim' e errëcirë,
Jashtë veriu pëllet!
Bie bor' e breshërirë,
Dheu duketë si det!

Është natë, nat' e zisë...
Vetëtit edhe gjëmon!
Një Engjëll i-Perëndisë
Dergjet sëmur' e rënkon!
Ka tri dit që po mundonet
Dhe me vdekjinë qërton,
Po vdekja s' do të mërgonet
Se shpyrtin' e-saj kërkon!
„Perëndi, lemë të-gjallë
– Po lutetë mëm' e-mjerë –
„Të munt të rrit këtë djalë,
„S' ka një javë që ka lerë.
„Kush dot' a marrë ta rrijë?
„Jetimi qysh dotë rrojë?
„Kush doti apë të pijë?
„Si unë kush dota dojë?
„Kush dota dojë Stefanë!
„Më ndje o Zot i-vërtetë!
„Se Stefani ka babanë
„Dhe dota rritijë vetë".

Engjëll me këto fjalë.
Nga jet' e-rreme shpëtoi,
La baban' e-zi me djalë!
Dhe ndë Qiell fluturoi!

III

Botë, moj Bot' e-pa-besë
Nuk ke gjë të vërtetë:
Njeriu po dotë vdesë
Dhe nukë vjen më në jetë.

Dotë gdhietë një ditë,
Dotë vijë një mëngjes
Nukë dotë sho të-mitë:
Dotë mbyll sytë të vdes!

Dotë qajn' e të-vajtojnë,
Dot' më mbulojnë me gurë,
Pastaj dotë më harrojnë
Dhe si-kur s' kam qenë kurrë!

IV

Kur shkoj në për varre ku ka mbirë bari
Që rritet' e maet me trupinë tënë,
Kujtoj kush ka vdekur, mentoj ç'kanë qenë,
Zëmra më lëndonet dhe s' pushon së qari.

Gjithë kanë qenë të-gjallë si unë,
Të-varfër, të-pasur, të urt' a të-marrë,
Mbase kanë dashur, qeshur' apo qarë,
Po të tërë vdiqnë dhe në varr i-vunë!

U lutem moj eshtra të kujt ini vallë?
Edhe kurm' i-bukur ç' u-bë, ku e-latë?
– Kujto djalërinë... një Engjëll, një natë
T' iku nëpër duar dhe të-la me djalë. –

⁂

ZOLEJKA

Nga gjith vëndet, Misiri,
Ka qën' e është n' i-miri:
Gjithë monë jeshil bari;
S'ka të sosurë behari...
Pem' e lule gjithë moti!
E-ka bekuarë Zoti.
Piramidhetë me diell,
Kanë kokenë në Qiell.
Buxhit Nili nat' e ditë,
Bie ujë të floritë...
Vadit fushënë të tërë
Nukë ka vënt të mos zërë.
Ujiten dhe hurmadhjetë

Dhe venë, venë përpjetë.
Veriu s' reshtetë kurrë
Kur zë e lot me pëlhurë,
Mbanë Nilit punë-mbarë
Ka qenë **Tani,** më parë,
Ka qenë krye-qyteti
Se këtu kish fronë mbreti,
Tani, ka qenë një herë
Qytet i-math e i-gjerë;
Në mes të këti Qytetit
Ka qenë Palas' i-Mbretit
Se në këtë qytet rroi
Apofi, kur mbretëroi.
Pranë mbretit, nga veriu,
Rrinte Zoti Petefriu,
I-nderuar ndë Misir
Se mbreti e-kish vezir.
Mëndje-math e zëmër-mirë
Kishte në dorë Misirë:
Petefriu mbretëronte

Se Apofi shum' e donte;
Apofi me Petefrinë
Bashkë rrinë, han' e pinë...

Petefriu u martua
Mori Zolejkënë grua.
Moj Zolejkë, nga ke dalë
Që ke diellin në ballë?
Zolejkë kush të ka bërë
Që manitenë të tërë?
Të ka bërë Zoti vetë,
Nukë ke shoqe në jetë!
Kush pa bukurinë tënde
Dhe nukë lojti nga mënde?
Kur do Zolejka të dalë
Me karocë ja me kalë,
Vetëm a me Petefrinë,
Ysmeqarkat pas i-vinë;
Kur del Zolejka merr erë
Dalën dhe shumë të tjerë,

Nukë rri njeri pa dalë;
Kush ta shojë më në ballë!

Zolejka rri e mentuar
Dhe vë kokënë në duar...
Ysmeqarkatë s' guxojnë
Të lozën e të kërdojnë.
Ç' ka Zolejka që s' gëzon?
Zonjë si ajo kush rron?
Kush ka të tilla të mira?
Kush ka gjëra të pa vdira?
Kush ka burrë më të mirë?
Burr' i-saj urdhron Misirë!...
Dashuri moj dashuri!
S' peshon ergjent e flori!...
Sa para bën madhëria?
Nukë blihet dashuria.
Duro Petefri, duro!
Zolejka nukë të do!...

Apofi, mbret' i Misirit
I-tha një ditë vezirit :
Për nga sivjet s'kemi vatë.
Po të vemi këtë natë.
Se ditën bën shumë vapë;
Në mëngjes kthenemi prapë.
Mbreti këto fjalë foli :
Petefriu jashtë dolli,
Ysmeçin' e-ti kërkoi
Të Zolejka e-dërgoi
T' i-thotë të mos a presë.
Në pezul të penxheresë
Rrij Zolejka, si nga herë,
Kur pa Josifnë më derë.
Nukë qe njëzet vjeç djalë.
Mustaqja s' i-kishte dalë ;
Ish i-bukurë si çupë
Dhe për të pirë në kupë.
Arapinkatë këndonin.
Zolejkënë përgëzonin.

– Zonjë, më dërgoi Zoti
Petefriu fuqi-ploti
Këtë natë mos e-prini
Vetëm të hani të pini:
Për gja sonte dotë venë
Që të dy bashkë me mbrenë. –
Këto tha djali dhe priti,
Po Zolejka psherëtiti:
– Pse mban kokënë më nj' anë?
Qasu të rrish këtu pranë,
Dhe Petefriu me mbrenë
Ku të duan le të venë.
Ti të rrish sonte me mua,
Josif die që të dua!
Të dua, të dua shumë!
Dhe gdhij natënë pa gjumë...
Që ditënë që të pashë
Zëmërnë time t' a-dhashë.
Dale të të puth një herë!
Këtë natë mos më lerë

Vetëmë me ysmeqare,
Josif bënu djal' i-mbarë!...
Eja të rrish këtu pranë,
Kuvëndomë për babanë
Për mëmën që të ka bërë
Dhe për njerzi' e-tu të tënë.
Pse ke lënë Mëmëdhenë?
Kush të shiti, ku të gjenë?
Pse erdhe zure Misirë? –
– Jeshë foshnjë, s'mbaj mënt mirë...
Po vëllezret që kam pasur
Si vëlla s'më kanë dashur,
Dhe më shitnë për të holla!...
– Faqja jote posi molla,
Goja jote si qershia,
S'të çmonetë bukuria!...
Të due, Josif, të dua!
Sonte dotë rrish me mua;
Dotë ham' e dotë pimë,
Të dy vetëm dotë rrimë!...

Se është jona kjo natë,
Zoti e böftë të gjatë!
Zoq e bilbilë, këndoni,
Kur të gdhihet të na zgjoni...
Mos ki turp, mos u bën djalë.–
– Zonjë, zonjë, të jam falë!
Jam rob' i-Zotrisë suaj;
Këto fjalë mos m' i-thuaj!...
Jetim i-shkretë, fat-ziu,
Më ka blerë Petefriu,
Si baba më është sjellë,
Më ka rritur si pjellë,
Më ka mbajtur me shpresë:
S' guxoj t' i-dal i-pa-besë!...
– Nga burri im mos ki frikë:
Mbaj me vete këtë thikë,
Prapa derësë të fshihesh
Dhe kur të vijë t' i-biesh!...
Vraje Petefrinë vetë!
Pastaj të më kesh për jetë...

O Josif, mos u-largo!
Josif, Zolejka të do!
Rri me mua këtë natë...
Nukë jam si gjithë gratë:
Gjithë trimatë më duan,
Mbreti për mua le gruan;
Po si ty s'dua të tjerë,
Lemë të të puth një herë!—
Edhe e-puthi sa deshi.
Josifi u-ngre nga sheshi,
I-mjeri kërkon të dalë...
Zolejka ju ngjit si ngjalë,
Üzëmërua sa qau!
Dhe zu Josifnë nga krau!
Ky e-shtyti me të fortë
Dhe dolli jashtë më portë.
Zolejka mbet turpëruar
Me sakon e-ti në duar:
(Josifi, që ta lëshojë,
Qiti sakon të shpëtojë).

Dita s' qe dhe gdhirë mirë,
Zolejka si egërsirë
Nga inati që kish marrë
Priti burrën duke qarë!
Ç' ke që qan o shpirt, i-thotë
Dhe vate t' i-fshijë lotë
Po Zolejka qan më shumë.
– Ku më le vetëm o lumë?
Ike më le me të tjerë...
Josifi më prishi nderë?
Erdhi natën të më zërë
Dhe ra me mua të flërë!
Dotë më kish turpëruar
Si kur të mos jeshë zgjuar!
Të mos keshë këtë thikë...
Kur e-pa i-erdhi frikë
Dhe hapi derën e shkoi
Po sakon këtu harroi!–
Kur ndégjoi Petefriu
Gjithë këto fjalë, ngriu;

Kur pa dhe sakon e-tia
I erdhi rrotull shtëpia :
Zolejkën të turpërojë
Josifi ?.. tani të shojë...
Dhe urdhëroi t' a-zënë,
Brënda në budrum t' a-vënë!

Kopshti i Dashurisë

O Pëllumb' i-shkruar
Dot' të marr në duar
Dhe duk' e kënduar
Gjetkë dot' të shpie :

Në një vënt t' uruar
Dhe të lulëzuar

Në nj' të kulluar
Edhe nënë hie;

Afër tek një lumë
Ku ka lule shumë
Të biem në gjumë;
Hëna të na ndrijë;

Yjtë të shukojnë,
Zogtë të këndojnë
Edhe të na zgjojnë
Dita kur të vijë.

Pa ngrën' e pa pirë
S' mbetemi, moj Mirë,
Se un ndaj të gdhirë
Dërgoj e na sjellin:

Qumështë të dhirë
Dhe djathë të mirë

Pa uj' e pa hirrë,
Dhe rrush kur të vjelin;

Ngjalë nga Janina,
Mjaltë nga Kanina,
Verë nga Voshtina,
Ujë nga Sopoti;

Mollë nga Horia,
Mish nga dhent' e-mia,
Desh nga Labëria
Na e falë Zoti.

BUSH

PLAKU

Moj mike ç' është kjo punë?
U plaksh' e nukë më nje!
Kur të bënesh ti sa unë
Nukë dotë jesh si je.

Njeri s' ka mbeturë djalë,
Dot' a humpsh dhe ti të-ritë:
Vjatë që kam në ballë
Dot' i kesh dhe ti një ditë.

Kur më shukon, mos mbyll synë
Dhe mos qesh me pleqërinë:
Kam qënë dhe u si tynë,
Si u dot' bënesh dhe tinë.

U plakshë si dhe të tjerë:
Pleqëria s' ka të sharë:
Nga ti më parë kamë lerë
Prandaj u plakshë më parë.

Punëtë vinë me radhë
Si ç'do gjë në këlë jetë:
Sot unë kam lesh të bardhë,
Nesër dot' i kesh dhe vetë.

Po me gjithë pleqërinë
Kam dhe u lezet në botë:
Se në ke ti bukurinë
Unë kam zëmër të ngrotë.

Mos harro ashtu më rruash
Se dhe pleqtë kanë gjak...
Ndaj të lutëm të më duash:
Nukë jam dhe shumë plak:

Më duketë se jam djalë,
Se s'ka pleqëri për mua,
Dhe shpyrti kur të më dalë
Moj mike, dotë të dua.

NYJA TRI...

Tri kanë qënë Bukuritë:
Frosina, Talia, Aglai,
Tri janë dhe sot Perënditë:
Fruma, i-Biri dhe babai.

Tri gjëra bukuri e thjeshtë
Të zeza duetë ti ketë:
Vetullatë, Sytë dhe Leshtë,
Që të na pëlqejë për jetë.

Tri gjëra të kuqa të jenë:
Faqetë, Buzëtë dhe gjua;
Këto rëfejënë shëndenë
Dhe bukurinë tek një grua.

Tri të-tjera të bardha shumë:
Cipa, Thojtë, Dhëmb' e dhëmballë,

Që-lënë trimatë pa gjumë
Edhe mëndjen e-bëjnë dhallë.

Tri gjëra të trasha, të plota:
Lëra, Çapoku edhe Gjiri,
Bëjnë që manitenë bota
Edhe lozinë nga figiri.

Tri gjëra të-gjata i-dua:
Këto janë Qafa dhe Shtati
Dhe Pleksidhatë ngjer më thua,
Mjer' ajo grua që s' i-pati.

Tri gjëra të vogla kur janë:
Vërsa dhe këmbëtë me duar,
Fat-miroshe gratë q' i-kanë,
Bukuria s' u-ka të ç-muar.

Tri Gjëra mbetenë të tjera;
Gjosku, Turiri dhe Balli

Duetë të jenë të gjera
Se për tô më ka marrë malli.

Tri të ngushta të ketë femra:
Goja, Mesi dhe... ç' o të jetë
E-treta gjë që m' a-do zemra ?
S' e-them dot po gjejeni vetë.

Kasapi

Pyeta një ditë
Kasap gjakëtorë
Që ther bagëtitë,
Me thikë më dorë...

O kasap o djalë
Ther qenqnë në ballë

Dhe delen e-mjerë
Le për tjetër herë.

„Jam kasap, më thotë
Duke fshirë lotë,
Po jam zëmër-miré
Se s' jam egërsirë.

Qengjitë, nō ballë,
Thikënë s' ja heq
Se delja e-ka djalë
Dot' i-vijë keq.

S' është pun' e-drejtë
Dhe për bagëtitë
Të rrojnë pleqtë
Të vdesën të ritë."

Dhe kasap' i-zi
Ka zëmër të bardhë,

Po ti Perendi
Pse s' punon me radhë?

O Zot, të jam falë,
Po nukë bën mirë:
Lë mëmëm të-gjallë
Dhe i-mer të birë!

Fyell' i Bariut

Bariu, shokë, bariu,
Kur gjëmon e fryn veriu,
Është përjashta fat-ziu,
E-rre breshëri dhe shiu!
Barinë, shokë, barinë,
Mos e-harroni fat-zinë,
Se le gruan e shtëpinë,
T' u kullosë bakëtinë.
Kulloni moj bakëti,
ti, ti, ti . . .

Kulloni biro kulloni,
Kur të vdes të më kujtoni,
Ndjesë pastë të më thoni,

Shukoni barin' e-gjorë :
Në diell a në tëborë.
Bariu, me shkop në dorë,
Ruan deshtë me këmborë,
Vështrouje barinë mirë,
Me të ngrën' e me të pirë,
T' u marrë dhëntë pa gdhirë
T' i kullosë me dëshirë,
Të rrijë bashkë me të,
to, to, to . . .

Hani moj bakëti, hani,
Kur të vdes dotë më qani,
Për mua zi dotë mbani !

„DËSHIRË *)"

I.

Kush lë mikenë që ka
Edhe ndaetë me shokë
Për të fituar para
Nuk' i-ka mënt në kokë...
Ikëni more të mjerë,
Hiqni Dëti tek t' u-nxjerë,
Se për mua, dashuria,
Ara, vresluti dhe shtëpia
Me bëjnë të rroj me gas,
Se s' dua të lë gjë 'pas,
S' dua t' iki si përpara,

*) Nota: Shumë nga këto vjersha janë shqipëruar nga Vjershëtori Latin „Tibull".

Dua të rroj në për ara,
Mikja pranë të më ketë;
Të punoj aratë vetë,
Fat-mirosh! mot e nga mot
Grur' e misër të kem plot,
Të kem raki, të kem verë
Të ëmbëlë si shëqerë.
Të vete me bakëti,
Me qe, me dhën e me dhi,
Dhe t' i-shpie rëzë malit
Të hanë majën e barit,
Dhe kur të pjellë një dhi
Dot' i-ve keenë në gji,
Nuk' ikë nga Shqipëria
Si punojn' ata që s' dinë:
Mos e dhëntë Perëndia
Të ndaem me dashurimë:
Sa të munt të rroj me pak
Po këtu të bënem plak;
Dhe në vuaj, le të vuaj,

Të mos vdes në vënt të huaj!
Të shoh mëmën e babanë,
Të kem dhe motratë pranë,
Dhe kur të vdes të më qajnë
Pa zakonetë që kanë;
Të më marrënë në duar,
Të qajnë me lesh lëshuar,
Dhe mikia kur të vijë
Të qaj' e të ulërijë

II.

Ku janë vaftet e parë?
Stërgjyshret sa mirë qenë!
Shkonin jetënë pa ndarë
Edhe dojnin Mëmëdhenë.
S' kish pampor e s' kish gjëmi;
Nukë vinin të fitonin,
Atdhenë s' e-lij njeri,
Po punonin edhe shkonin.

Kau nukë kishte zgjedhë,
As fre për kalën e-fortë...
Dhe si s' kish njeri të vjedhë
Shtëpitë qenë pa portë...
Aratë s' kishnë sinuar,
S' kish të pasur e të varfër
Dheu qe i-lulëzuar,
Kafsh' e njers rronin të afër...
Nukë kishte njers të liq,
Dhe lufta s' kishte dhe dalë,
Gjithë bota qenë miq,
Qenë vëllezër në ballë...
Po tani, Zot' i-Vërtetë,
Njeriu gjan me arinë!
Nukë hiqetë kjo jetë
Se njeriu ha njerinë!..
Sot s' mbretëron dashuria;
Nukë kemi dashuri;
S'na mbeti as triměria!
Sot rrojmë në robëri!

III.

Sot e tutje, më shtëpi.
Mikia të mbrctërojë,
Cili do nga miqt' e-mi
Për zonjë duet t' a njojë.
Kur të vete në për ara,
Kur të korr o kur të mbjell,
Të kem mikenë përpara
Kur të shij e kur të vjel.
Dhe në stan kur të më shojë
Me qe, me dhen e me dhi,
Mikia t' i-numëroje
Se mos m' i-vjedhë njeri.
Të më zbukurojë stanë.
Të bëjë djathë, të butë.
T' u-hedhë qënet të hanë
Të na ruajn' nga hajdutë.
Edhe nata kur të vijë,
Të marr mikenë në gji...
Dhe hënëza të na ndrijë
Dhe të na ketë zili!

IV.

O shokë, ç' u-prish dynjaja
Si për burra dhe për gra;
Tani shitetë sevdaja...
Mjer' ai që s' ka para.
I-pasur, të pallië varri!
Ti që bleve dashurinë
Dhe nuk' e-le si më pari,
Të martë Djalli shpyrtinë!
Ndëgjoni more të ri,
Ndëgjoni dhe ju të ra:
Duani atë që di,
Jo atë që kn para.
Duani dhe vjershëtorë
Mbarambar me Perëndinë,
Se rri me lule më dorë
Edhe këndon Dashurinë.
Ata që janë lëvduar
Me këngë, nga vjershëtori,
Janë burra të ndëgjuar

Dhe rrojënë sa Tomorri!
O ju të ra e të ri
U lutem të më këndoni
Që të kini dashuri;
Kur të vdes të më kujtoni.

V.

Moj mike kam bërë bé
Të marr syt' e-mi të shkoj,
Se me nazetë që ke
Me ty nukë mund të rroj!
Nukë të bëra faj kurrë,
Gjë të ligë s' të kam bërë;
Dhe kur jeshe e-sëmurë
S' më zinte gjumi të flërë!
Luteshë te Perëndia
Me metani dit' e-natë,
Të t' apë nga dit' e-mia,
Të kesh jetënë të gjatë.

Qysh të bëj more të mjerë
Që ditënë q' u shërua,
Mikja zuri miq të tjerë!
Edhe lot e qesh me mua!

Një dit' iku e më la
Se do një që ka para.
Nalet paç moj Dashuri
Se më trete si qiri.

Dua të dejem me verë
Të munt të harroj qederë,
Dhe të zë mike të ra,
Të më lënë si më la...

Po as vera s' më zë kurrë
As me mike s' bënem burrë...
Dhe më thonë, me mëri:
Të kanë bërë magji!

– S' më zënë magjitë mua,
Po kujtoj atë që dua. –

VI.

Mike pse më prish fiqirë?
Vetë vije më kërkoje...
T'ani ku gjete më mirë?
Pse s'më thoshe kur s'më doje?
Më thuaj që më do shumë.
Po janë fjalë të rreme:
Ikën e më lë në gjumë,
Edhe më punon llagëme!
Gjithë-një më turpëron,
Dhe më përvëlon si zjar!
Dhe të ligat që punon
Guxon e m' i-zë niqar!
Mjer' ia që të ka grua!
Nalet pastë kush t' a dha!
Se dot' a gënjesh si mua,
Me tjertipe të mbëdha.
Mos e-besoni ç' u-thotë:
Gruaja nukë ka besë:
Dashurin' e-ka për botë

Që kur len e sa të vdesë!
Kush nuk' është i-zoti vetë
Të rrojë gruan që merr,
Kurrë grua të mos ketë
Në do të rrojë me nder.
Qërto thirrë sa të duash
Gruaja s' e-prish qederë:
Sa më shumë do t' a ruash
Aqë shumë do të tjerë!
Këto bënenë në botë:
Burrat që rrojnë nga gratë
Se nukë janë të zotë,
Turpëronen dit' e natë...
Të pyeni dhe të tjerë
Po të mos besoni mua:
Shini Adhamutn' e-mjerë
Se ç' heq, fat-ziu, me grua!
Sos qirinë dot' i-mbajë!
Sos të shara të durojë!
Se s' ka, i-gjori, të kajë;
S' është i-zoti të punojë!

VII.

Moj mike, kush të gënjeu
Dhe të shiti a të bleu;
Ay që të gjeti burrë
Mos paftë të mirë kurrë.
Sëmund' e-madhe t' a zërë;
Të mos mundij dot të flerë;
Gjithë natën t' ëndërrijë;
Të mos haj' e të mos pijë;
Uqrot e qëntë t' a hanë;
Të shojë lugat babanë!
Tëtilla ka për të vuar
Ay që na ka trazuar.

VIII.

Ata që më kanë sharë
Për dashurinë që kam,
Janë gjithë njers të marrë
Se i-parí nukë jam.

Kush qesh me hallet e mia,
Qesëndis me dashurinë,
T' a gjejë nga Perëndia,
Ç' kanë me mua fat zinë
Me egërsira të rrojë;
Tisifoni me Serberë,
Dit' e natë t' a mundojë,
Të mos shojë drit' e erë;
Zot, të vdesë nga uria,
Për ujë t' a marrë malli,
T' i-zhuritet mushkëria,
T' a pësojë si Tantali!...

IX.

Dotë pi raki dhe verë
Të munt të harroj qederë;
Të harroj hallet e-mia
Se plasa nga dashuria,
Se dhe mikia që dua
Mbyll portën dhe qesh me mua!

O moj portë moj e-shkretë
Mos rri mbyllturë për jetë:
Hapu për mua një natë
Moj të çaftë një sëpatë!
Hapu moj portë një herë
Se bie shi e fryn erë!...
Shtëpia prapa te fiku,
Del mike se të do miku;
Moj pse s' del apo s' të lënë?
Sos je mollë për të ngrënë!
Moj mike moj jetë gjatë
Gdhiu me miknë një natë.
Pse s'guxon të dalç të dera
Si bëjnë shoqet e tjera?
Pyet të rit' e të ratë
Ç' punojnë, moj jetë gjatë:
Çupa, me tertipe shumë
Le mëmën' e-saj në gjumë
Dhe hap derënë nga-dale
Të vejë të lozë valle;

Dhe gruja që ka burrë
Shtiretë më të sëmurë,
Dhe kur bënetë më mirë
Ryn më shtëpi ndaj të gdhirë.
Eja, sa jemi të gjallë,
Të lozëm ballë për ballë,
Të duemi më të fortë
Se kemi vdekjen' në portë,
Ea sa jemi të ri
Se kemi dhe pleqëri:
Kur bënen leshtë tëborë
Dhe dasburia heq dorë...
Vajza humbet bukurinë
– Bukurinë që ke vetë –
Dhe djali humbet fuqinë,
Kur zën' e shkojënë vjetë.
Zot i-Math e i-Vërtetë,
Mëndja jote nukë diet:
Djalëria shkon për jetë
Dhe gjarpëri përtëriet!...

X.

Kur të vijë dhe për mua
Dit' e fundit, nike dua
Të vdes në duar të tua:
Kur të më shukosh të vdekur
Dotë qash se s' je nga hekur,
Se s' jemi më për të pjekur!
Kur të më bëjënë varrë
Dotë më puç duk e qarë
Se s' jemi më për të parë!..
Dotë më qash moj e-mjerë
Se s' piqemi tjetër herë!
Dot' më qajnë dhe të tjerë,
Se këndova dashurinë,
Këndova dhe Trimërinë
Mëmëdhen' e Perëndinë.

XI.

Moj mike të bëj porsi
Vetëmë mua të duash;

Mos të gënjejë njeri
Po nderinë t' ënd t' a ruash.
Merr një plakë nga mëhalla
Të të ruajë nga herë,
Dhe të të thotë përralla
Me kandile duke tjerrë.
Dhe gjumi kur të të marrë
Mbac plakën më shtëpi;
Shuaj llambën edhe zjarrë
Dhe vetëm bjer' e fli.
Në mëngjës duke këcyer
Të vi vetë të të sgjoj;
Kur të më shoç papandyer
Të më lesh të të pushtoj.

XII.

Gjithë natën e vadesë
Fryntej er' e bintej vesë;
Derëziu po të presë
Në pezul të penxheresë

M' a bëre me të pabesë.
Dhe kur dha Zoti mëngesë
U-sëmurç' e daj' të vdesë
Se nukë rroj dot pa shpresë.
Ç' më duetë jeta mua
Kur s' më do ajo që dua
Lesh-verdha gjera më thua,
Cicat posi lemua.
Ç' të këndoj për të më parë?
Dhëmbëtë margaritarë,
Buza si qërshi e kuqe
Goj' e saj posi bubuqe;
Sy-zez' e vetullë-hollë
Faqetë si koqe mollë
Mes' i saj si rreth unaze
Më lodh e më vret me naze.

XIII

Të më bën Zoti dhe mua
Një profit një noitua

Që të dijë mënt' e-tua :
Vallë më do sa të dua ;
Se me gojë s' më the kurrë
Më do as s' më do për burrë.
I-ziu jam i-sëmurë,
Më digjet koka si furrë!
Se nga dashuri e-shumë
Nat' e ditë rri pa gjumë.

XIV.

Zëri qan, shpyrti rënkon,
Zëmëra katran kullon . . .
Pse moj mike më mundon
Pse ulë kokënë kur shkon
Dhe bën si kur s' më shukon ?
O mor i-ziu Andon
Pse vajton e pse këndon ?
Mikja zënë s' a ndëgjon,
Dhe n' e-ndëgjon s' të beson.
Nga të të besoj' e mjera
Kur ndëgjon fjalë të tjera ?

XV.

Babai nalet të ketë
Që s' të martoi dot vetë,
Dhe nënës i-palltë varri.
Që s' të vloi më së pari.

Ç' e do jetën edhe gjënë
Kur s' ke burrë për të qenë?
Ç' të duetë gjër' i-shkretë
Kur s' e trashëgon dot vetë?

Gjënë që të la babai
Dotë ta hajë xhaxhai
Se xhaxhai me kunanë
Prandaj të dhanë çobanë.

XVI.

Më qafë të pastë kush të ka martuar:
Me burrën që more nukë ke të shkuar.

Jetime, kur humbe mëmën e babanë
Të vunë në dorë motra me kunanë!..
Motra tu bë bushtrë moj e-mjera Rinë,
Dhe burrë për jetë të dhanë efgjinë!
Mir ata t' a dhanë po ti qysh e doshe?
Qysh e more burrë? e vogëlë s' jeshe.

XVII.

Në mos kupëtove
Motra ç' të punoi
Pse nukë kujtove
Zotnë q' e verboi?

Ditënnë q' u vlove
Me këtë zuzar
Nuk' e kuptove
Që s' qe Shqiptar?

Kur more efgjinë
E-vure ndë gji
Nuk' i-pe turinë
Si thingjill i-zi?

BKSH

Pjes' e Tretë

PËRRALLA TË VERTETA

DHE TË RREME

BKSH

BKSH

MISIRI

Fushë dhe fushë, dhe fushë prapë
Fush' e pa sosur dhe shumë vapë,
Mal-s' të shë syri, as brek, as gurë,
Po gjithë momë tym' e pëlburë;
Miza dhe pleshta dhe morra shumë,
Kunap' i-shkretë të lë pa gjumë.
Era e ngrotë, ujëtë trumbull;
Fiku me gjëmba, pjepri si kungull.
Përrënj s' ka fare, vetëm një lumë,
I-math si deti, mbulon me shkumë
Fushën të tërë, gjithë Misirë.

Çupë pa prishur, burrë pa brirë...
Nuk' i-ngrë vëndi!.. O vënd i-mbarë,
Vënd për hajdutë dhe për beqarë!
Të ka bekuar vet' Perëndia:
Në mot dy herë pjell bakëtia;
Dhe grat' e-mjera s' humbasën konë:
Pjellën e mbarsen pa zënë monë!
Aratë s' reshten, i-vadit Nili;
Tek korret gruri, mbillet trifili,
Elbi dhe misri, thekra, pambuku,
Dhe dëm e kotë s' mundonet bujku.
Qetë si buaj, qeni si ujku.
Pyll s' she dot kurrë, as re në Qiell;
Fshatratë xhveshur digjen në diell.
Udhët plot çuna, Koshet plot mjaltë,
Shtëpit, kasolle bërë me baltë,
Lyer me bajga brënda dhe jashtë,
Janë mbuluar me dru dhe kashtë.
Kuaj të mirë dhe të lëvduar,
Gomarë shumë dhe të ndëgjuar.

Njerstë të verbër nga të dy sytë,
Burrat pa larë, shumë të ndytë;
Gratë të zeshka, bienë erë,
Si buk e djathë e hanë nderë...
Si kundrë thonë ata q' i-dinë,
Shumë të shpejta për dashurinë;
Din' e kënaqin, po të pa besa...
Këtu s' ka borë, shiu si vesa;
Behari furrë, dimri si vera;
Bashkë kullosin dhëntë me derra.
Shtëmë të pasur e të pa punë
Në dimër vinë rrinë këtunë.
Në për qytete, nga Minaretë
Hoxhët pëllasën me zë si qetë.
Njerstë betonen për Muhamenë
Dhe kur i falen puthinë dhenë!
Udhëtë shtruar me gur si shtufë;
Njerzitë venë, vinë si tufë,
Z' bathur e z' veshur dhe të ngarkuar
Po parësia m' umbrell në duar,

Dhe grat' e-tyre dalën mbuluar.
Vdes njeri? Gratë zen' e vajtojnë,
Qajn' ulërijnë sikur këndojnë.
Këtu ka prince dhe pashallarë,
Bejler më tepër se nga gomarë.
Të pasur shumë sa s' dinë ç' kanë
Po më të shumët s' kanë të hanë.
Përmi të gjithë **një Efendinë**
Qeveris vëndë nënë Anglinë.

I Krishteri dhe Çifuti

I krishteri: Si këtu dhe n' atë jetë
Besa jon' është e-vërtetë,
E ka bërë Krishti vetë.

Çifuti: Çifutë Krishtin s' e-dinë,
Besojënë Perëndinë,

Si përpara dhe taninë.
I krishteri: Krishti është Perëndia.
Çifuti: E polli zonja Maria.
I krishteri: Me Frymën e Shënjtëruar.
Çifuti: Me Josifnë që martuar.
I krishteri: Është djal' i-Perëndisë.
Çifuti: I biri zonjës Marisë.
I krishteri: Punëratë që punoi,
Ujëtë q' e bëri verë,
Të sëmurët që shëroi;
Lazar' e shumë të tjerë
Që ka ngjallur përsëri,
S' e rrëfejnë Perëndi?
Me gjithë këto çudi
Që bëri Krishti në jetë,
Si e patë dhe ju vetë,
O milet i-mallkuar,
Nukë qe për të besuar?
Çifuti: O kaur' o kokë thatë,
Besonje ju që s' e-patë...

Se ata q' e kishnë parë
S' besuan: po e varrë;
I krishteri: Nga dashuria për ne
Nukë zëbriti për-dhe?
Nukë hoqi, nukë voi?
Nga o-liga s' na mërgoi?
Nga Shejtani s' na shpëtoi?
Çifuti: Pse s' u shpëton nga Turqia
Q' u bën kaqe të këqia?
Se ahere tok me ju
Dot' a besoj' edhe u!..

Kurbeti

Mitrua, kur u martua
Ndënji një muaj me grua!
Erdhi dita për të ndarë
Dhe u ndanë duk' e qarë!
Gruaja qënkej me barrë
Dhe kur poli, bëri djalë.
Po Mitrua ku ish vallë?
Motë-mot që qe larguar
Një kartë s' i kish dërguar!
Ku t' i-shkruaj mëm' e-mjerë
Për djalënë që kish lerë?
Tri vjet, katrë, dhjetë shku-an!
Mitrua harroi gruan!
E-varfëra se ç' pësoi,
Të ritë vetëm e-shkoi!
Ç' e-deshi të tillë burrë
Që s' e pati pranë kurrë!

Gjithë bota ven' e vinë;
Mitrua harroj shtëpinë!
Nuk' e di që ka dhe djalë!
Rron a kà vdekurë vallë?
Këto thosh grua e-mjerë,
Po burrit i-mbajti nderë.
E-zeza grua se ç' hoqi!
Humbi shpresën tek i-shoqi;
Kur pa ngrënë' e kur pa pirë,
Punoj' e rriti të birë.

Kurbeti, shokë, kurbeti!
Kush vate e nukë mbeti?
Mitrua zuri Misirë.
Po puna s'-vinte mirë.
Qysh të vejë puna mbarë
Për të zestë Shqipëtarë?
Shkretojënë Mëmëdhenë,
Tek perndon dielli venë!
Ku vini more të mjerë?

Se sot s' është si një herë:
Qysh vini në vënt të huaj
Kur s' dini as gjunë tuaj?
Lum kush rron në vënd të ti,
Me qe, me dhën e me dhi...
Mos u-ndani nga shtëpia
Të mos mpshojë Perëndia.
Se Perëndia kur mpshon
Gjynaqarët i-mundon.
Puna nukë ka të sharë
Po punoni vetë nd' arë,
Zini çapën e hostenë
Dhe parmendën që çan dhenë.
Nga fëmia mos u-ndani
Po punoni që të hani;
Grurët që bëni vetë,
U harrin për këtë jetë.
Me zakonetë që kini
Kurbenë duet t' a lini.
Të nderçim ini të zotë,

Po nderi sot s' ka të shkuar,
E-ndreqta, në këtë botë,
Është fare shtrëmbënar . . .
Në kurbet venë të tjerë;
Ata që s' duanë ndrerë.
Sot zakonet u-udërruan:
Burri që fiton shet gruan.
Burratë rrojnë nga gra! . . .
Po për Mitro Shqipëtarë
Këto zakone, të ra
Nuk' i-dukeshinë mbarë.
Ndaj hoqi e voi shumë
Kur pa huk' e kur pa gjumë.
Krau Misirë të tërë,
Nukë la punë pa bërë,
Gjithë jetën nënë urdhër,
Qesea si kokë udhër!
E-shoqia e kish qarë;
Një zet vjet që s' e-kish parë!
Dhe në mos e-paftë kurrë,

Djali ju rrit, u-bë burrë:
Mëmën dot' a mbajë mirë
Me të ngrën' e me të pirë.
Pas një zet vjet, nga kursimi
Mitros ju çtua fitimi;
Solli nër mënt Shqipërinë,
Gruan' e-ti dhe shtëpinë;
Psherëtiti zëmër' e-ti
Dhe qau si çilimi;
Dhe nesërmet, ndaj të gdhirë
Mitrua e-la Misirë.
Ta kish ditur, kur ish ndarë
Që la gruanë me barë,
Mbase kish ikur më parë.
Shtatë dit e shtatë net
Bëri Mitrua në det;
Mbaroi udhën' e-gjatë
Dhe vate në fshat me natë.
Në shtëpi u-afërua,
Ndënji pak e u mentua

Dhe me vete të tij thosh:
Në gjeça shtëpinë bosh?
Në mos e-gjeça të gjallë
Gruanë! — Me këto fjalë,
Shikon shtëpinë me dritë
Edhe vate në fengjitë
Të shojë kush është brënda,
T' i përgjojë ja ka ënda.
Djali kuvëndon me mënë:
— Pse qan i-thosh kur ke mua?
Ç' kanë shkuarë t' i-lenë,
Dhe duajmë si të dua. —
— Të dua, thosh mëm' e-mjerë,
Me shpresë tënde kam rruar,
Nga ti harrova qederë
Dhe gjith' ato që kam vuar,
Dhe sot rroj me shpresë tënde. —
Kur gjegji këto kuvënde
Mitrua ngriu në fengjitë;
Fat-ziu, ç' vuri nër mëndë!

Vuri syn' e pa në dritë,
Pa një trim të ri me grua!
Mëndia ju trumbullua!
Mitrua kujton Misirë,
Sheh vetëhenë me brirë!...
O Mitro mentoju mirë,
Mëma përkëdhel të birë;
Nnkë të ka turpëruar
Se me nder të math ka rruar!
Ç' mentonej more fat-zi!
Ryrë mbrënda në shtëpi
Dhe merr djalënë në gji.

O Bobo! sytë ç' më panë!
Tha Mitrua si i-marrë,
Pashë gruan me jaranë!
Po tàni dot' u bëj varrë!
Dot' u-bie me kobure
T' i lëshoj në shesh shondure
Mua të më vënë brirë!...

Tha, dhe goditi të birrë!
Mem' e-zezë ulëriti,
Pushtoi djalën dhe briti!
Po Mitrua nukë priti:
Puçka krisi dhe një herë,
Ra përmbys dhe mëm' e-mjerë!

Gomari jatro.

Që një herë në një ko
Një gomar u bë jatro;
Vjerr' i-ti s' punoi mbarë
Kur bëri dhëndër gomarë,
Vetiut' i lëri varrë
I-mjeri ço çe pandeu
Se gomari e gënjeu.
Nga inati, nga qederi,
U-sëmur një ditë vjerri.
Si e-dinte të shtrënguar,

Të shëroj u pa poguar,
Vate gomari e thotë
Dhe bënte sikur fshij lotë.
Tani të të sho ç' ke msuar,
Tha vjerri duk' e rënkuar.
Mori ilaçin' e e-piu
Po ai qënkej bar miu
Zorrët e mulçit' i griu!
Më helmove, tha i-ziu,
Dhe me të tilla ilaçe
Nesërmet u gdhi kopaçe!...

Jet' e-ligë.

Të mos kesh' e të mos dish,
Të jesh si një copë mish...
Të mos dish si të punosh
Po nga gruaja të rrosh,
Ti bënesh rob dit' e natë
Për ca pak bukë të thatë:

Ta durosh kur të të rrajë!
Dhe të qeç kur të të shajë!
Të mos të të mbajë nderë,
Po të të thotë nga herë:
„Ush! gomar në për shtëpi,
„Si të them u të bësh ti,
„Ndryshe të le pa tagji"!...
Nuk besoj që të ketë
Më të fëlliqurë jetë,
Dhe një burrë q' është burrë
S' besoj ta durojë kurrë.

****

Ujku bekshi.

S' ka njeri të pa mardhë:
Katrë motra, një vëlla
Dotë qenë si ata,
Se Perëndia u-dha.
Po i-gënjen një xhaxha

Soisës e maskara,
Gjënë që kan' u a ha
Dhe i-mban për sadaka!
Punuan si çilimi:
Vunë ujkunë bekshi
Të ruajë dhën e dhi!
Pse s'dolli një nga të pesë
Ta dbonte qen' e pa-besë.
S'e shonë që s'ka të frytë,
Djalli u-ka zënë sytë!

Një xhaxha me dy dhëndurrë.

O njeri i-ndytë
Djalli të zu sytë!
(Të arht'e të mbytë)
Nukë ke të frytë,
U bëre fanua:
Me mbesat' e-tua

Rron si burr'e grua!...
Gjën'u a zotove
Dhe i-turpërove!
Dhe dy që martove
U-dhe njers të-mbetur
Dv doçre të-gjetur!
Dy burra të-shitur...
Duk'e lipur rritur!
Që të dy gomarë
Për të zënë nd'arë;
Që të dy çiplak,
S'kanë pikë gjak.
Të këtill'i-gjete
Ti kesh nënë vete
Ti kosh me bobotë
Se s'janë të-zotë.

PUSH

Neron i ri.

U trete o nik u trete,
U bëre si druri thatë,
Se mban mbesatë me vete
Dhe flë me to dit' e natë!
As në Turq' as në Kaurë
E-tillë punë s'ka gjarë,
Katrë motra me një burrë
Dotë bënenë me barrë!..
I-ke mbesa mor i-mjerë!
Mirë gjën' u a-zotove,
Po tu kesho lënë nderë . . .
S' keturp se Neron e shkove!
Po në leftë nonjë djalë,
Dhe për turp në këtë jetë
N'e-lëntë Zoti të-gjallë!
Mëm' e-zezë çdo ta ketë?
Pjell' a kushëri të-parë?..
Perëndi të jemi falë,
Ti që mundon gjynaqarë

Hap dhen' e fute të-gjallë;
Balta baltën të mbulojë,
Të mos lërë fis e farë,
Se dotë na turpërojë
Tërë Korçën me Korçarë!

Mik me dy fytyrë.

Pse s' të kupëtova
Që jeshe i-lik,
Fjalët t' i-besova
Se të dije mik.

Në shtëpi më vije,
S' kishe pik gjak,
Tek' u haj' e pije
Se jeshe çiplak.

Ta kesh për lëvdatë
Që qeshe me mua,
Po kthemë paratë
Që ke marrë hua.

Korbi dhe Dhelpra

(Shqipëruar)

Zoti korb një ditë, me djathë në gojë
Në një degë lisi vate të qëndrojë.
Nëne his një dhelpër korbin e-kish parë,
I-ra erë djathi dhe kërkon tja marrë.
Fat-mirosh më qënke! thotë zonja dhelpër,
Bukurinë tënde nuk' e-ka zok tjetër!
Pëndë të florita si ndërkur i-doje!
Të keshe dhe zënë dotë mbretëroje!—
Të rrëfejë zënë, zoti korb gërhiti,
Djathët ra nga qefti, dhelpëra e-priti...

Si dhelpra, Turqia qesh me Shqiprinë:
Kur na ka nevojë na mburr trimërinë;
O burra! na thotë, trima Shqipëtarë!
Në luftë të vini të vriti më parë!

Dhelpra dhe një kokë Greku

Dhelpr' e-mallëkuar
Dolli për të gjuar.
Tek zëbrit nga bregu
Pa një kokë Greku.
—Jashtë, për të dukur,
Qënka kok' e-bukur.
Po s' paska tru miku!
Tha dhelpra, dhe iku.—

Gruaja me barrë.

Një grua me barrë
Në shesh po rënkonte,
Thërrit duk' e-qarë
Se s'munt të shpëtonte.
E-mjera se ç' hoqi!
S' gjëntej dot rehat!
Ngreu, thosh i-shoqi,
Të shtriesh në shtrat;
Të lutem ndëgjomë,
Shko të pjellç në stromë.
—Ç' kuvëndon or burrë?
Dotë ndëgjoj ty!
Barku ç' fryet kurrë
Atje tek u-fry?

Lopa, dhia, delia dhe asllani.

(Shqipëruar)

Mos bëjë kurrë njeri
Me të mëdhej shoqëri.

Lopa, delia dhe dhia
U-bënë shoq me asllanë,
U-ndanë nga bakëtia
Dhe për gja një ditë vanë.
Kur rynë ndë një përrua
Asllani thotë: qëndroni!
Dhe ndënji pak u-mendua;
— O shokë, thirri, ndëgjoni:
Ç' më duetë gjau mua?
Lopa, delia dhe dhia
Janë mjaft, të tjera s' dua! —
Dhe i-çau që të tria.

BIGH

Qeni dhe hieja

(Shqipëruar)

Një qen me ca mish në gojë
Në për lumë dotë shkojë.
Ujët është si pasqyra :
Qenitë ju duk fytyra,
Ju duk dhe mishtë më shumë!
Ryti t' a zërë në lumë.
Fat-ziu mbeti pa mish
Se humbi dh' atë që kish
Se e la e-mori vala.
Ndëgjoni ç' thotë përralla :
Njeriu që vë tanma
Humbet dhe gjënë që ka.

Ujku dhe Qengji

(Shqipëruar)

Një qëngj pinte ujë, brenda në përrua,
Një ujk' e-kish parë dhe ju afërua.
Pse trumbullon ujët? thirri gjakëtori,
Se kur e pa, qëngji nga frika përmori.
– Ujët vete poshtë, ti pi për mi mua,
Thotë qëngj' i-mjerë, qysh u-trumbullua? –

– Janë gjashtë muaj, pse më keshe sharë? –
– Unë s' keshë lerë, ku të keshë parë? –
– Për zonë, tha ujku, ati yt me shau! –
Dhe u-hoth e-zuri dhe me dhëmb' e-çau

Me gjak, me të reme, mbretëron dhe Turku
Pa faj na ha kokën, se punon si ujku!..

Eva dhe Shejtani

Gjith' e dinë ç' kemi qënë
Dhe pastaj qysh kemi rënë:
Që të prishet njerëzia
Të ndahet nga Perëndia,
Shejtani dolli nga dheu
Dhe Evën vate gënjeu,
Edhe Eva më pastaj,
Genjeu burrën e saj...
Dhe e kandisi, fat-zinë,
Të harrojë Perëndinë.
Q' atë dit' a q' atë natë
Burrat bëjnë ç' thonë gratë...
Edhe gratë, (qoftë lark),
Kanë shejtanë në bark.

Shtatë herë fajtor?

Nga mëndja juaj mos dili
Po ndëgjoni ç' thot' Ungjilli:
Në një ditë, burr' i-mjerë
Ryn ndë gjyna shtatë herë!
Po m' e-nderçimja nga gratë
Sa gjyna bën në një natë?
Ungjilli s' desh t' i-tregojë
Se s' mundi t' i-numurojë.

Njeriu i-shtrënguar

Kush ësht' i-shtrënguar
Dridhet për paranë:
Gjithë ç' ka fituar
S' i-ha po e-hanë!

Nukë menton, lumi,
Se ka për të vdekur,
Dhe kur e-zë gjumi
Bie flë si ljepur...

Ruan gjën' e-tia
Tja hanë të tjerë,

Dhe vdes nga uria
Mos më keq i-mjerë!

Greku dhe Shqipëtari

Greku: – Pse, ju Shqipëtarë,
Kini djem të mbarë,
Të zgjuar, të zotë,
Të fort e të plotë?
Shuko djemtë tanë:
Sikur nukë hanë,
Të verdhë, të thatë,
Të trembur si gratë,
Të liq, të pa-besë,
Pa turp e pa shpresë...
Gjak në zëmër s'kanë!
Tuajtë pso janë
Trima të vërtetë?

Shqipëtari: – Se i-bëjmë votë.
S'na ndinë të tjerë,
Si ju, mor të-mjerë.

E Shtunë! e Dielë

(Shqipëruar)

Mbanë pusitë, një herë,

Ndënji një Çifut i-mjerë ;
Nuk' e di si u-ndoth bosh,
U-këput e ra përposh!
Një Kaur andejë shkonte,
E-ndëgjoi tek rënkonte,
Dhe vate pruri një shkallë;
Po Çifuti s' desh të dalë:
„Sot është, tha, e-Shëtunë
Dit' e krëmte për Çifunë".
— Si të duash, i-tha miku,
Dhe mori shkallën e iku.
Çifuti, si ja desh ënda,
Mbeti atë natë brënda,
Ndënji pa ngrën' e pa pirë,
Dhe nesërmet, ndaj të gdhirë,
Çifuti kërkoi shkallë
Që të mundijë të dalë
Dhe të shojë drit' e diell,
„Po sot është dit' e Diel,
„E-krëmte për të Krishterë,
„Sot s' punojëmë të tërë",
Tha duk' e qeshur Kauri,
Dhe iku e shkallë s' pruri.

Burri me grua

(Shqipëruar)

Markua dotë vdesë,
Nuk' i-mbeti shpresë,
Dhe gruas i-thotë
Duk' e fshirë lotë:
– Dotë vdes moj grua:
Jam keq i-sëmurë!
Po hajde më thua:
Që kur më ke burrë,
Ma ke mbajtur ndorë?
Nga mua, më mirë
Ke dashur të tjerë?
Më ke vënë brirë?
Folë, mos ki frikë,
Trego të vërtetën,
Se dhe për një çikë
Dot' a humbas jetën.
– Po n' u-shërofsh prapë?
E-shoqja i-thotë
Dhe mori një napë
Për të fshirë lotë.

DRËRI

Këngë (Shqipëruar)

1.

Kush vjen të vemi për gja
Se tani koha u hap ?
Dhe çifte kush nukë ka
Të vijë tek' u t' i-ap
– Ik' o mik, ecë për gja,
Le jot shoqe më shtëpi,
Se ka hedhurë sevda
Dhe pret të largonesh ti...

2.

Ti vete të godiç derrë,
A një ljepur, a një drë.
Një ajdut të run më derë,
Me jot shoqe bie flë!...
– Ik' o mik ecë për gja,
Le jot shoqe më shtëpi,
Se ka hedhurë sevda
Dhe pret të largonesh ti...

3.

Drëri përpiqet më nj' anë,
Lavoset bie në shesh;
Dhe jot shoqe me jaranë
Në shtëpi po lot e qesh!...

– Ik' o mik ecë për gja,
Le jot shoqe më shtëpi,
Se ka hedhurë sevda
Dhe pret të largonesh ti...

4.

Ti rjep drënë që ke yrarë
Dhe langoi gjakn' i-pi;
Jot shoqe bënet me barrë
Me miknë që ka në gji.
– Ik' o mik, ecë për gja
Le jot shoqe më shtëpi,
Se ka hedhurë sevda
Dhe pret të largonesh ti...

5.

Ti merr drën' e-vë në hell,
Vjen në shtëpi me dëshirë;
Ahere jarani del
Edhe run dëri me brirë!...
– Ik' o mik ecë për gja
Le jot shoqe më shtëpi
Se ka hedhurë sevda
Dhe pret të largonesh ti...

O bobo! (këngë)

O bobo! e u bubu!
Mikia nër mënt e vu;
Në shtëpi të saj më shpu,
Se nënen s' e kish këtu;
Po shejtani na i-pru
Dhe na gjeti gju-për-gju!..
– Bijë ç' është ky këtu?
– Moj nëne mos thirrë kshtu;
I varfër e i vjen mu,
Dhe kërkon kulaç të gru.–
Thotë plaka i ap u
Dhe vate mori një dru!..
Ik' ajo e ikë u...
M' uzu këmba më një hu,
Vrava të shkretinë gju
Edhe rashë si kërcu!
Plaka po vinte tëhu,
Erdhi nga veshi më zu
Dhe më dha kulaç të gru!..

VARFËRIA

Këngë. (Shqipëruar)

Më thonë ca njers të marrë:
Pse nukë kurcej paranë?
Pse nukë sillem i-mbarë?
Pse nukë vë gjë më nj' anë?
– Ata që thonë këto,
Janë me tru të sëmurë,
Se ai që s' ka sa do,
Nuk' i tepëron gjë kurrë.

Më thonë të punoj shumë
Edhe të flë pa tama;
Po ditën e-shkoj në gjumë
Se nukë kam se ç' të ha!
– Ata që thonë këto,
Janë me tru të sëmurë,
Se ai që s' ka sa do,
Nuk' i tepëron gjë kurrë.

Më thonë, duk' e qërtuar,
Andon, hiq dorë nga gratë!
Po as një s' m' ësht' afëruar
Se shonë xhepnë të thotë...

– Ata që thonë këto,
Janë me tru të sëmurë,
Se ai që s'ka sa do,
Nuk'i tepëron gjë kurrë.

Më thonë që s'sillem mirë,
Nukë mblidhem në shtëpi.
Në bie flë ndaj të gdhirë
Jam beqar s'më pret njeri...
– Ata që thonë këto,
Janë me tru të sëmurë,
Se ai që s'ka sa do
Nuk'i tepëron gjë kurrë.

Më thonë të mos pi verë,
Me raki të mos gënjenem.
Po si të harroj qederë
Kur të mos pi sa të dejem?
– Ata që thonë këto,
Janë me tru të sëmurë,
Se ai që s'ka sa do,
Nuk'i tepëron gjë kurrë.

BKSH

Katrëmbëdhjetë vjeç dhëndërr !

Komedi e vjershëruarë

Me Katrë Pamje

BKSH

Njerst' e Komedisë:

Zoti Vangjel: plak i-pasur.
Zonja Tanë: grua e-ti.
Gjini; djal' i-tyre.
Marigo: nuse e-ti.
Zonja Kote: kushërir' e Tanës.
Zonja Briri: një lehonë.
Një millona.

Prifti.
Numi.
Brodani.
Abazi

Krushq

Gra, burra të tjerë, çupa, djem.

Bkt

PAMJE E PARË: Burr' e grua.

(Është natë. Mbrenda ndë një odë për të fletur zoti Vangjel e zonja Tanë bëhen azër për të rënur poshtë. Në funt të odës ndrit një llampë afër shtratit).

Tana. Ndëgjo, burrë...

Vangjeli. Ç' ke moj grua?

Tana (rënkon). Jam sëmurë.

Vangjeli. Që kur! ç' thua

Tana. Ç'them? ja them që jam sëmurë:
Koka më digjet si furrë;
S' e-keshë pësuar kurrë...

Vangjeli. Po tani vallë ç' pësove?
Më duketë se u-flove:
Gjithë natën u-zbulove;
S' di se sa herë më zgjove;
Dhe s' më le fare të flërë!...

Tana. Gjithë ditën ç' keshe bërë?
Ti për bar e për dru s' vete,
Dhe qaej se nukë flete?
Tërë ditënë ngas qetë,
Dhe drek' e darkë bëj vetë!

Gjithë puna përmi mua!

Vangjeli. Përse të kam marrë grua?
Gratë për punë po janë.

Tana, qesëndis. Edhe burratë të hanë,
Dhe të rrinë nat' e dit!..

Vangjeli, me inat. Mos më bën të të godit;
Se zakonë s' e-harrova...
Sonte shumë të durrova...
Nga hunda s' më iq dot kurrë..
Se nukë jam si ç' do burrë!
Jam Shqipëtar i-vërtetë,
Dotë bëj si dua vetë!
Ç' ke që s' pushon duk' qarë?
Nga u ç' të ligë ke parë?
S' të kam lënë, si të tjerë,
Vetëm, të shkret' e të mjerë...
Nuk' ika kurrë nga fshati.
Ëa, s' të shkoi inati?
Ngreu të biem të flëmë,
Dhe këto fjalë t' i-lëmë.

Tana. Bjer' e fli, mua s' më tlet.

Vangjeli. Nesër, porsa që të gdhiet
Dot' dërgoj djalën me vrapë

Të bjerë jatronë prapë
Tana. Cinë jatro?
Vangjeli. Adhamutnë.
Tana. S'e sho dot me sy Çifutnë,
As për mace s'i-vë besë...
Vangjeli. Le moj grua t'a thërresë.
Kokën munt të t'a shërojë.
Tana. Nuk'e-dua të më shojë!
Të bukhr jatro që gjete...
Me prahir të ruaj qetë.
Vangjeli. Mos kuvëndo kshtu moj grua.
Tana me inat. Nuk'e-dua, nuk'e-dua!
Pse s'shëron gruan e-ti?
Se nga ajo ha e pi..
Ndaj e-mori me një sy
I-dalçinë që të dy.
Vangjeli. Ç'jatro ti të bie unë?
Mitrua s'është këtunë;
Dhe Naum kokë shiniku
Këtejë natënë iku...
Në vënde të tjerë vanë,
Këtu vetëmë na lanë!
Ikn'e muarrë Misitë,

U hante koka për brirë!...

Tana. Prapa diellit të venë
Se ç' nderuan mëmëdhenë.
S' jam sëmurë për jatrua
Se s' më ka gjë koka mua;
Po të më ndëgjosh një fjalë...

Vangjeli. Folë, ç' dotë thuash vallë!
Dot' më lesh dhe sot pa gjumë?

Tana. Kemi ara, vreshta shumë...

Vangjeli. Të gjitha ç' duen i kemi,
Si do vetë Zoti jemi;
Si ne s' ka shumë të tjerë...

Tana. Sa që e-ndyera vjerrë,
Pas takatit pleqërisë,
Bëntej punët e shtëpisë,
Dhe kur kthenesh nga ara
Gjëjë darkënë përpara;
Po tani ç' të bëj më parë,
Në vështë të jem a nd' arë?
Të të bëj dhe drek' e darkë,
Tani s' munt se jam më plakë.

Vangjeli. Plakë? s' je plakë moj grua,
Po je ashtu si të dua...

Tana, me të lutur. Të të vijë keq për mua :
Punëtë janë të rënda;
S' punoj dot jashtë dhe brënda...
Vangjeli. Puno sa të duash vetë ;
Arat, epi me të tretë.
Tana. Kjo punë s' bënetë kurrë,
Po djali na u-bë burrë...
Ndaj të lutem t'a martojmë,
Erdhi dita të gëzojmë ;
Ne, pa nuse pse të rrimë ?
Kur të kem nusenë ndimë
Punëtë bënenë vetë.
Nukë rojëmë më jetë!...
Pse s' më flet ?
Vangjeli. Ç' të them moj grua ?
Çuditem me ç' fjalë thua!
Katrë mbëdhjetë vjeç djalë
Do t' a martosh ?
Tana. Sa jam gjallë
Dua të gëzoj si mëmë!...
Vangjeli. Ea të biem të flemë...
Tana. Ti ç' më thua, u ç'të them!
Sikur kemi shumë djem!

Me Gjinë mbeti kjo derë.
Vangjeli. Qasu të të bej të tjerë,
Të pjellç pa mbushurë moti...
Tana, duke qarë Me fjalë je shum' i-zoti
Vangjeli. Ç' ke që qa prapë tanimë?
Tana, me lot. Ku të mos qaj un' e-mjera?
U të flas me Perëndinë,
Ti më flet fjalë të tjera!
Vangjeli. Ea moj grua nër mënde.
Tana. Çuditem me kokë tënde.
Vangjeli. Sado qave, ngreu bjerë...
Tana. S' je baba si dhe të tjerë!..
Thuajmë, për Perëndinë,
Pse s' do t' a martojmë Gjinë?
Vangjeli. Ësht' i-vogëlë moj Tanë!
Tana. Ç' thua? pa shukoi shtanë:
Bota nukë shonë vjetë;
Shie sa mori përpjetë:
Duketë një zet vjeç djalë
Kur hipën e breth me kalë.
Me mua kur u-martove,
Sa vjeç jeshe, mos harrove?
Tani, për djalënë tonë,

Do të ndërrojmë zakonë?

Vangjeli. Mos kërko ç' bënim një herë,
I'o shuko ç' bëjnë të tjerë:
Shuko bejnë, rrenjë dalë,
Nuk ka dhe ai djalë?
Kur i-thashë t' a martojë,
„Le të bëjë si të dojë,
„S' më ha malli për t' im birë,
„U për vete të rroj mirë",
Më tha dhe më ktheu kratë.

Tana. I-muarrë mëntë gratë!...
Të bukur njeri që gjete!
Ai të kish mënt për vete!
Nukë shkretonte shtëpinë,
S' kish marrë porropotinë!
Mëndje prishur, zëmër-ligu,
La të shoqenë dhe iku!...
E-zeza grua se ç' hoqi,
Një zet vjet e-la i-shoqi!
Dhe në pleqëri q' e-poqi,
(Të mos arrij të kish ardhë)
Nukë pa ditë të bardhë;
Nat' e ditë duk' e qarë

Nga turpetë që kish parë...
E-mba mënt ç' grua ka qënë?
S' kishte shoqe në vënt tënë:
E-ndershme, zëmër-mirë,
Punoj' e rriti të birrë:
Ka qënë grua për mbrenë;
Burri s' ja diti qimenë...
Dhe tani në pleqëri
Dashuri më dashuri!
E gjetë nga Perëndia
Se prishi shtëpinë e-tia.
Gruaja vdiq nga qederi!
Këtë kërkonte dhe derri;
Tani mban disa të tjera,
I-vaftë shpyrti në ferra!...

Vangjeli. Pse kuvendon kshtu moj Tanë?
Njerst' e-mëdhej kshtu e-kanë:
Njerst' e-tyre i-mundojnë,
Duan' ata q' i-lëvdojnë...

Tana. Në bëjnë kshtu të mëdhejtë
Djalli t' i-marrë për jetë!..
Beu djalën t' a martojë!
Me sy nukë do t' a shojë!

Se në turpe do të rrojë
Si ka rrojturë nga herë! . .
Dhe guxon e mson të tjerë!
Ka lojturë nga fiqiri
Një ditë më thosh i-biri:
„Baban e mirë nderoe,
„Dhe baban' e-lik duroe".
Dotë bënet djal' i-mbarë
Se më mëmën ka gjarë;
Pa në gjaftë me babanë ...

Vangjeli. Minji gdhietë moj Tanë!
Tani le bejnë më njanë
Dhe hajde të flemë pranë,
Ea se më mori gjumi. (shtriet).

Tana. Dhe mua më mart lumi!

Vangjeli. Pa dhe nesër kuvëndojmë.

Tana. Djalënë dot' a martojmë?

Vangjeli. Pa të shomë ...

Tana. Ç' do të shoç?
Nuk do të më ndëgjoç!
Ndëgjo dhe mua një herë.

Vangjeli. Të ndëgjoj po hajde bjerë.

Tana. Të vi po të më apsh fjalën

Që dot' a martojmë djalën.
Vangjeli. Puna s' bënet me një natë,
Do mentuar gjer e gjatë.
Tana. Ç' do mëntuar, pa më thua?
Vangjeli. Ç' vajzë dot' i-apëm grua?
Tana Mos e-ki këtë qeder:
Djalën tënë kush s' e-merr?
Kush nuk' e-do Gjinon tim
Q' është nga trimat më trim?
Vangjeli. Trimërinë s' ja nxë dheu!
Tana. Nuk' është si djalë beu...
Po ësht' i-mir' e i-mbarë,
Kush t' a-rëmbejë më parë;
S' është no një djal' i-mbetur;
Unë nusen ja kam gjetur.
Vangjeli. Ja ke gjetur! Po ç' e-thonë?
Tana. Çupën' e gjitonit tonë.
Vangjeli. Cinë çupë, Marigonë?
Çupën e zotitë Kore?
Tana. E-bukur' e punëtore.
Mos pyet se ç' grua është...
Si për ara dhe për vështë,
Pun' e saj s' gjëndet në jetë,

Punon vetëmë sa dhjetë!
Nukë them mirë? ti ç'thua?

Vangjeli. Në do të më ndëgjosh mua
Gjini, Katonë të marë
Të bënem krushk me Korçarë
Ara, vreshta, shumë kanë.

Tana. Po kanë veqil xhaxhanë
Nuk' u-ep bukë të hanë!
Janë për të qarë hallë
Se të tjer u-hanë mallë:
Tek ata që s'kanë mënt
Erdhjendi nukë zë vënt.
Xhaxhai pse s'i-marton?
Se vetë, thon' i-punon!...

Vangjeli. Ç' thonë bota për xhaxhanë?
Kjo punë s' bënet, moj Tanë,
As në Turq as në Kaurë.

Tana. Tym pa zjarr nuk ka kurrë.
Ndaj s' i-do njeri në fshat,
I-shukojnë si lugat...
Kanë dhe Jorgjin kunat
I-nzjer vetë në „mëzat",
I-taks andej' e këtejë,

Cinë munt që të gënjejë:
Gënjeu nja gjasht' a shtatë!
Të mjerët! humpnë paratë
Se harruanë xhaxhanë
Q' e-kish vluar me çobanë.

Vangjeli. Mos ndëgjo bota se ç'thonë.

Tana. Ti pse s' e-do Marigonë?
Ajo nuse bën për nua.

Vangjeli. Po ësht' e-madhe, moj grua,
Një zet vjeçe!...

Tana. Kaq' e-dua:
Nukë marr nuse për sisë,
Po për punët' e shtëpisë,
Të dijë të ngasë qetë
Se nukë munt t'i ngas vetë,
Të na bjerë dru nga mali...

Vangjeli. Mirë ti, po ç'thotë djali,
Gjini me të do të rrojë?

Tana. Do-e-mos që dotë dojë!
Pse kuvëndon kshtu mor burrë?
Pyeten fëmia kurrë?
T' a martojm' ashtu me rruash.

Vangjeli. Moj grua, bën si të duash.

Dhe më qafë t' i-kesh vetë...

Tana. Em këtu em n' atë jetë.
Nesër dot' vete të bluaj,
Të shëtunë të gatuaj,
Të Diel të bëjmë darsmë,
Gjithë miqtë t'i-gërshasmë. (qa)

Vangjeli. Tani pse qa?

Tana. Qa nga gazi:
Më shpëtove nga marazi.
Tani dotë bënem vjerrë!

Vangjeli. Shuaj dritën, dhe shko bjerë.

(Të dy bien të flenë në shtrat. Perdea mbyllet)

PAMJE E-DYTË

Në Mulli

(Brënda në një mulli dy gra presën të bluajnë: Zonja Tanë dhe zonja Kote. Gur' i mullirit po Kthenet. Dukenë thasëtë me drithë pranë koshit. Zonja Kote kërkon të bluajë më parë po Tana s' e-lë).

Tana. Ç' bën ashtu moj Kote?
Kote. S' është puna jote.
Tana. Moj mos je e-marrë?
Kam ardhë më parë.
Kote. S' mund të rri këtunë,
Kam të tjera punë.
Po hiqu nga unë...
Tana. Ç' thotë kjo **murtajë!**
Kote. Ujku të të hajë.
Tana. Tutje, moj **mandatë!**
Kam ardhë me natë.
Kote. Thuaj si të duash
Se u dotë bluaj.
Tana. Nukë dotë bluash,

Se u këtu ç' ruaj ?

Kote. Ruaj millonanë
Se kur të ka pranë...

Tana. Ftu ! moj gojë ndyrë,
Moj turi lëtyrë !
Ç' e-kam millonanë ?
Kam burrënë pranë...
Ti ku e-ke nderë,
Që përflet të tjerë ?
Po gjithë të dinë :
Harrove bekshinë...
Sa herë të zunë ?

Kote. Me bekshinë, unë !
S' turpëronej pakë
Se je grua plakë !

Tana. Plakë ? pa hap sytë,
Kush është m' e-ndytë ?
Jeshe ti për burrë ?
Ndaj iku i-mjerë
Dhe s' të vjen më kurrë
Se i-prishe nderë !...

Kote. Moj kurvë, moj shtrigë !

Tana. Moj grua e-ligë!
Kote. Moj sterrë, moj natë!
Tana. Moj gojë lopatë!
Kote. Moj byth' e kusisë!
Tana. Tmer i njerëzisë!
Kote. Na! porr' ato paç
Kur kërkon të shaç!
Tana. Tutje moj zagare!
Kote. Tutje moj murdare!
Tana. Ikë moj lisht dredhur!
Kote. O moj brashnj' e-bedhur!
Tana. O moj vjedharake!
Kote. O moj shulanake.
Millonai. Ç' kini që thërrini,
Pak turp nukë kini?
Ini kushërira!
Silli si të pira!
Pse thërret moj Kote?
Kote. S' është puna jote.
Millonai. Zonja Tanë ç' patë?
Tana. S' kam ardhë me natë?
Kote. Po se pse ke ardhë?

Tana. Të bluash me radhë!
Millonai. Thotë mirë.
Kote, shtyn millonanë. Ç' thua?
Millonai. Pse shtyn, ç' ke me mua?
Tana, të millonaj. Ç' e-shukon, ç' i-thuaj?
Kam ardhë të bluaj,
Se martoj evlanë!
Millonai. Ç' faj të kam moj Tanë?
Tana. Le thesnë, moj batë!
Millonai. Kthenet guri thatë!
E-gjeç me Perndinë!
Më prishtë mullinë!... (bën të dalë)
Tana. Ku vete;
Millonai. Ç' më thuaj?
Tana. Kur të vi të bluaj?
Kote. Kurrë, kurrë, kurrë! (dhe ikën)
Millonai. Kur të skalis gurrë.
Ikë në ke punë
Pa t' a bluaj unë.

Tana. Sa të ndreqetë mulliri,
Dot' vete te zonja Briri

Ka dy dit që polli, msova
Dhe akoma s' e-urova;
Të vetę sot t' a-uroj
Edhe më darsmë t' a ftoj.
Shuko mos më lesh pa miell!
Të vię më darsmë të Diel.

PAMJE E-TRETË

Urime

(Ndë një odë për të fletur, zonja Briri gatuan gjell për të ngrënë, kur ryn zonja Tana për të uruar. Kur e shę, zonja Briri që është lehonë dhe ka frikë se mos marrë sysh, shtriet në stromë pranë foshnjës që ka pjellë e q'e-ka vënë në djep.)

Tana. Mirë që shëpëtove!
Po ç' dit' u-lërove?

Zonja Briri. Duk' e gdhir e Marrë.
Tana. Qoftë këmbë mbarë...
Dy dit që ke pjellë
Dhe ngriej bën gjellë!
Kshtu jeshë dhe unë:
Polla të Shëtunë,
Të Diel u-ngrita
Dolla e vadita;
Dhe djalën e-parë
E-kam bërë nd' arë!
Në piqi e-vura,
Në shtëpi e-shpura,
Dhe në sis' e-kisha,
Kur erdhë nga kisha,
Burri ù mamit
Vjerra u çudit.
E'-ngreç u-ndërrova,
Zura e gatova,
Drek' e darkë shtrova.
Sot të tjera thonë:
Kush është lehonë
Jashtë të mos dalë;

Këto janë fjalë!..
Hëngre nonjë çikë?
Pive nonjë pikë?
U-mundove shumë?
Pse s' flet, mos ke gjumë?
Dotë rri dhe pakë
Se s' kam bërë darkë:
S' iki pa shukuar
Foshnjën' e bekuar...
Gtu, ftu, ftu! të rroftë,
Zoti t' a dhuroftë
Këmbë mbarë qoftë!
Po si lul' e Mait!..
Nuk' i-gjan babait:
Gjyshit i-ka gjarë;
Ti s' e-keshe parë:
Qe një burr' i-bukur,
Nga shokët m' i-dukur...
Ndjesë pastë! Mua
Doj të më mir grua;
Mëma me babanë
Një tjetër i-dhanë.

(te foshnja) Ftu, ftu, ftu! mos qa.
(te mëma) Pa shi vallë ç' ka?
Pa nxire nga djepi,
Në do sisë jepi.
(te foshnja) Ç' ke që qa moj zëmër?
(te mëma) Mashkull ësht' a fëmër?
Zonja Briri. Vajzë.
Tana. Të të rrojë,
Zoti t'a madhojë.
Ndaj të sho mentuar
Dhe të hidhëruar!
Zonja Briri. Doje të qe djalë.
Tana. Ç' janë këto fjalë?
Ç' e keqe të zuri?
Të të rrojë burri:—
Me shëndet të vijë,
Ju ini fëmijë...
Pse qesh? tek të them:
Dotë bësh dhe djem.
(pshtyn foshnjën) Ftu, ftu! Kush t'a shojë
T'a mpshyjë në gojë
Është lodërtare.
Si motëmoçare!

Shumë njers moj bijë
Kanë për fëmijë
Sy të lik, mos qoftë!
Zoti e-verboftë!
Unë, pasha zonë,
Mos ndëgjo se ç' thonë,
Se kam sy të mbarë:
Një ditë të marë
Poqa Sanën nd' arë;
Punonte sa katrë!
Si thashë gjë tjatër.
Puna mbar' i-thashë
Dhe ika e-lashë;
Sana qe me barë
Po s' e-keshë parë!
Tër' ditën punoi,
Natënë dështoi!
Mua m' a ngarkoi!
Dil e thosh, murtaja,
Të shoqet e-saja
Dhe në gjithë botë
Duk' e fshirë lotë:
Tana, zëmër-liga.

Më vu synë, shtriga,
Pandaja dështova!
Po pas ca dit msova,
O moj zonja Brirë,
Që Sana kish shtirë
Se burri qe pirë...
Dhe e-rrau mirë!
Mbrëmanë, ndaj natë,
Me një bisht lopate,
Se s' kish bërë gjellë!
Po shi ç' ka jot pjellë!

te foshnja. Ç' ke moj vogëlanë?
Ç' do moj bukurinë?
Ç' më kërkon, ç' më thua?
S' më di, s' më nje mua?
Unë jam hall Tana.
Korba! ra kambana!

Zonja Briri. Mori „sperinoi"!

Tana. Moj motra, s' më thoi?

Briri. Shkoi dit' e-shkretë!

Tana. S' bëj dot as dy petë.
Kush ndëgjon Vangjellë
Kur nukë ka gjellë?

Sot dotë durojmë,
Shkojmë si të shkojmë,
Me buk' e me gjizë.
Tani nëmni izë;
Më mbajtit me fjalë!
Mos u-ndodhet dhallë?

Zonja Briri. Sot tunda.

Tana. Më rrofsh!
Të mos kthenem bosh,
Pa bakëti jemi,
Dhe dy dhi që kemi,
Sivjet mbenë shterpa,
Si Syska dhe bejka:
(ngriet) Nat' e-mirë! ika.
(kthenet prapë) Vaj! më rëntë pika...
Moj korba s' më thoi
Kush e-pagëzoi?

Zonja Briri. Zoti Koto, votë.

Tana. T' i roj' e t' a ketë!
I-lumt' ajo dorë.
Vëntë dhe kurorë...
Ç'emër i-ka vënë?

Zonja Briri. E-quajti, Hënë.

Tana. Moj sterra! moj nata!
U arthtë mandata!..
Zëmërn m' a-lënduat
Nuk u-turpëruat!
Zonja Briri. Ç' patë?
zonja Tanë. Ç' faj më kini?
Bëni sikur s' dini?
Vajza q' më ka lënë
Nukë qnej Hënë?
(duk' e qarë) Një zot vjet mbuluar!
Më ka përvëluar...
Kur gjegj këtë emër
Zhuritem në zëmër!
E-zeza ç' ndëgjova!
Dhe arç' e urova!
Mos e-trashëgofshi
Si un' e pësofshi!...
Zonja Briri. Me t' u-thaftë gjua!
Tana. Qënkej palo grua!
Qënki njers të ndytë! (dhe del)
Zonja Briri. Mos të pafsha sytë!...

PAMJE E-KATËRTË

Dit e darsmës

Ndë odë te krushqet sufra shtruar plot me mish të pjekur në hell. Burra, gra, çupa, djem, këndojnë a hidhenë vallë. Çoku kërcet no-një pushkë. Burrat e-shtrojënë me dolli, dhëndërri rri më këmbë, dhe dy a tre trima qirasin krushqit pas urdhërit „dolli-bashit". Këto të gjitha bënenë më darkë.

I.

Gratë vetëm

A të pëlqen nusia,
More djal' o lulia?
Është e-mir' e shoqe s'ka,
M'e-mirë nga gjithë na.
Nusja si zogë deti,
Si kur është bijë mbreti.

Gra e burra bashkë:

Ç'mirë ja bëm krushkësë
Qi muarm të bijënë,
A të më të mirënë:
Maro ngjeraqinënë.

(*Burrat vetëm, në valle*)

Moj unaza rreth me ar,
Për grua dotë të mar;
Gjithë të kanë nakar.
– Nakar le të kishninë
Sa të mos pëlcisninë

Moj unaza rreth flori,
Gjithë të kanë zili
Se dotë të marr ndë gji.
– Zili le të kishninë
Sa të mos pëlcisninë.

II.

(Burrat rrinë përdhe të pinë me dolli)

Nuni. Djalë, bjerë
Shtjerë verë,
Shtjerë, shtjerë
Në të tjerë..
Pini verë
Mor të mjerë,
Se qederë
Dot' ua nxjerë.

Gjithë burrat. Kush e-pi këtë dolli?

Zoti nun me trimëri,
I-gëzofshim më shtëpi.

Nuni, te prifti. O Prift, të kam gjetur,
Të gjëj me kupë në vorë
Të ëmbëlë si shilqerë.

Prifti. Tek' unë mir' se të vish.

Nuni. Këtë t'a dish e t'a pish
Për shëndet të dhëndërrit
Që rri më këmb' e dremit.

Gjithë tok. Shëndet të mirë të ketë,
Të trashëgonet për jetë!

(Këreet një pushkë)

Prifti, te nuni. Zoti, nun, mir' se më erdhe
Po verën pse na i-derdhe?

Nuni, te Prifti. Mir' se të gjeta, uratë,
Të kesh jetënë të gjatë.
Kupën e-piva me funt...
Dhe me tutje mo e-funt,

Prifti. S' e-pi dot, jam prift njeri

Nuni. Të di, uratë, të di...

Prifti. Kur e-bën emërë vetë,
Pikë në kupë mos mbetë!
Ti që vure sot kurorë,

Pagëzofsh edhe me dorë.

Gjithë tok. Nuni që vuri kurorë
Pagëzoftë dhe me dorë.

Prifti. Urdhër, o nun, se jam plak,
Të lutem, bëme konak

Nuni. Konak? gjëj Vangjel' e-shkretë.

Prifti. Këtë kërkoje dhe vetë!
Vangjel e-mira të gjetë.

Vangjeli. Me një kupë ço të jetë?

Prifti. E di mirë kush martonet?
Djali të të trashëgonet:
Dot' a pi pas urdhërit
Për shëndet të dhëndërrit!

Gjithë tok. Dhëndërri të trashëgonet,
Të gëzonet' e të shtonet!

Vangjeli. S' e-pive të tër' uratë!

Prifti. Për mbys e-ktheva, s'e-patë?

Vangjeli. O prift mirë se urdhrove,
Rrofsh e qofsh që më nderove:
Dhe dolli-bashi na rroftë,
Dhëndërri ju trashëgoftë.
Gëzofsh dhe më derë tënde.

Nuni. Dhe zoti të dhëntë mënde...

Vangjeli. Unë verën s' e-kam pirë

Që të mos kuvëndoj mirë...
Po dilmi paskam mënt pak,
Të lutem bëmë konak.

Nuni. Ç'konak kërkon të më thuash?

Vangjeli. Dërgomë ku do të duash.

Nuni. Zotnë Brodanë të gjesh
Dhe si të duash të bësh.

Vangjeli. O zoti Brodan të gjeta.

Brodani. Mir' s' erdhe, t' u ngjatë jeta.

Vangjeli. Këtë kupëzë, t' a dish,
Për dhëndërrin, plot t' a pish

Gjithë tok. Dhëndërri shumë të rrojë,
Jetë të mirë të shkojë.

Brodani. Zotrote që gjete mua,
Më shtëpi t' a paça hua;
Dhe dolli-bashi me nder
U bëftë dhe vetë vjer,
Dhe rroftë sa shkëmb' i malit

Nuni. Gëzofsh më darsmë të djalit

Brodani. Ku dot' më dërgosh të pshetem."
Se dotë pi e mos dejtem.

Nuni. Ecë pshetu te Abazi,
S' ka pir' e ju tha gurmazi,

Brodani. Të gjeta, Abaz i-mjerë.

Abazi. Kshtu të më gjësh kurdoherë.
Brodani. Këtë kupë do t'a kthej
Për shëndet të këtij bej!
(*rrëzon dhëndërrin*).
Gjithë tok. Me nuse të trashëgohet
Nga e liga të mërgohet!
Abazi te nuni. Dollibash, të qofsha falë
Zoti të faltë një dialë!
Nuni. Rrofsh e qofsh.
Abazi. Kush më ka gjetur?
Nuni. S'e ndëgjove? Keshe fletur?
Të ka gjetur Brodan Durri.
Abazi. Më ke gjetur, thotë nuni
Të gjett' e mira për jetë
Të rrosh sa të duash vetë.
Gjithë. S'mbá mënd? U-deje pa pirë!
Abazi. Dhe në mos kuvëndoj mirë
Un'i mjeri jam çoban;
Sos jam fatziu në stan
Dhe sos jini dhen'e dhi
Të di për cinë të pi.
Nuni. Ky ësht shëndet i parë
Për dhëndërrin mor'i marrë!

Abazi. Sa malet, o nun, të rrosh!
Tani ku do të më dërgosh?
Se dua të pi një verë

Nuni, numuron. Një, dy, tri, s'ka më të tjerë.

Abazi. Numuroi dhentë mirë.

Nuni. Le të kollet kush s'ka pirë...
Me mua, zoti Abas.

Abazi. Të gjeça kurdo me gas,
Këtë kupë do t'a pi
Për shëndet të dhëndrit ri.

Gjithë tok. shëndet të mirë të kotë
Dhe të gëzojë për jetë
I zot'i shtëpisë rroftë
Dhe djali ju-trashëgoftë.

III

(Soset dollia, dhe prifti ngrihet e zë vallen me burra, duke këndusr).

Do të them një këngë vetë
Këngë prifti të vërtetë:
Rroftë veshti dhe dheria
Rroftë vera dhe rakia

Q'i ka bërë Perëndia;
Se dhe Zoti Krisht një herë
Mori uj'e bëri verë.
Moj verë burrim i gjakut
Gaz'i djalit e i plakut!
O raki, moj bukuroshe
Që na hedh goshe më goshe?...
Se ç'bën vera dhe rakia!
Pin'e dejen trimëria
Sa vjen rrotull shtëpia...
Det' i ndidh e det i gjerë,
Pse s'të bëri Zoti verë
Se do t'a pinim pa bierë.

IV

(Ësht natë; krushqit zën e ikin duk'e uruar mëmën e dhëndërrit, zonjën Tanë, q'ësht shum' e gëzuarë).

Nuni. Të të trashëgohen
Brodani. Si bletë të shtohen
Abazi. Me jetë t'u rrojnë;
Prifti. Dhe t'u plëqërojnë.
Zonja Tanë. U paça; të rroni
gjithë të gëzoni.

(Një nga një ikin të tërë, dhe mbeten vetëm n'odë Tana me djalë e me nuse).

(Tana tek i biri).

– Rri me nusen djalë
Dhe foli dy' fjalë
Të mos ketë frikë.

(Dhëndërri i thotë s'ëmës)

– Ngreu, mëm'e ikë. (Tana ikën).

V

(Dhëndërri me nuse mbeten vetëm).

Dhëndërri

Lozëm ndonjë lodër?
Të dua si motër...

Nuseja

Ç'motër më ke mua
O lum'e përmua!...
Ti më more grua.

Dhëndërri

Pse u-zëmërove
Dhe u-idhërove?
Kur s'lot ndonjë lodër
S'të dua si motër,
Të dua si mëmë!
Po hajde të flëmë...
Se më mori gjumi.

Nuseja

Fli, të marrtë lumi!

FUND.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

RADHUA I VJERSHAVET

Pjes' e I.

	Faqe:
Dy fjalë	3
Baba-Tomorri	9-13
Mëmëdheu	14
Shqipëtar	15-18
Ku kemi lerë	19
Trim' i Shqipëris	20
Dëshir' e Skënderbeut	21-23
Sulltani	24-28
Prishj' e Likursit	29
Luft' e vitit 1856	30
Vaj	31-34
Kohëria	35-36
Besa-besë	37-39
Ç' jemi	40-42
Punëtat e Perëndis	43-44
Naim-be Frashëri	45-46
Atdheu dhe Dashuria	47-53
Varrëria dhe liria	54
Fshati i im	55-56
Dheu	57
Aleksandr' i madh	58

Pjes' e II.

Dashuria	69-70
Vajze	71-76
Zelejka	77-87
Kopësht' i dashuris	87-89
Plaku	89-91
Nyja tri	92-94
Kasapi	95

BIBLIOTEKA

	Faqe:
Fyell' i bariut . .	96-97
Dëshirë I-XVII . .	98-117

Pjes' e III.

Misiri	121-124
I Krishteri dhe çifuti . .	124-126
Kurbeti	127-134
Gomari jatro . . .	134-135
Jet' e ligë . . .	135-136
Ujku bekohi . . .	136-137
Një xhaxha më dy dhëndurrë	137-138
Neron' i ri . . .	139-140
Mik me dy fytyra . .	140-141
Korbi dhe dhelpëra (shqipërusar)	141-142
Dhelpëra dhe një kokë greku	142
Grunja me barrë . .	143
Lopa, dhia, delja dhe asllani (shq.)	144
Qeni dhe hieja (shq.) .	145
Ujku dhe qengji (Shq.) .	145-146
Eva dhe Shejtani . .	146
Shtatë herë fajtor . .	147
Njeriu i shtërnguar . .	147-148
Greku dhe Shqipëtari . .	148
E [illegible]së-E Dielë (Shq.) .	148-149
Burri më grua (shq.) . .	150
Dyert	151-152
O boho	153
Varfëria (shq.) . . .	154
Kat[illegible]më-dhjetë vjeç dhëndër (Kamedi) . . .	157-192

BKSH

BKSH

BKSH